



# Mirë se vjen MUAJI I BEKUAR I Ramazanit



# Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

"Drita islame"  
Botim i Komunitetit Mysliman  
të Shqipërisë

DREJTOR  
Dorian Demetja

REDAKTORË  
Andrin Rasha  
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA  
Ejup Lila

KONTAKT:  
Tel/fax 04 223 04 092  
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXX i botimit  
Nr. 03 (458)  
Mars, 2021

ISSN 2226-7115



Artikujt  
që vijnë në redaksi  
dhe botohen,  
nuk paraqesin domosdoshmërisht  
edhe pikëpamjet e revistës.  
Materialet e sjella në redaksi,  
pavarësisht nëse botohen apo jo,  
nuk i kthehen autorit.

## PËRMBAJTJA

- 4 Mirë se vjen muaji i bekuar i Ramazanit / Redaksia
- 6 Ramazan, ardhja jote na gëzon / Qani Sulku
- 8 Lajme / Aktivitete



- 12 Urrejtja e verbër / Nuredin Nazarko
- 14 Problemi nuk është mungesa e modernizimit, problemi është mungesa e identitetit  
Dr. Muhammed Seid Ramadan El-Buti
- 18 Agjërimi i muajit të Ramazanit / Shkëputur nga libri "Ilmihal i zgjeruar", Botim i tre komuniteteve fetare
- 20 Historia e universitetit në tre ajete / Blerim Lazimi
- 22 Çelësat e Qabes dhe ajeti i vetëm i zbritur në të / Taulant Bica
- 24 Nga tregimi kur'anor për Merjemen a.s., kam mësuar se lehtësimi vjen nga nuk shpresojmë  
Edhem Sherkaui



- 26 Sjellja e Profetit (a.s.) me njerëzit / Doç. Dr. Jener Ozturk
- 30 Hafiz Xhemal Mullai (1881 – 1959) / Xhemal Balla
- 32 Këshillat e njëzet e tre filozofëve / Imam Isa Hoxha
- 34 Ndikimi i dhunës psikologjike / Aisa Kokiçi
- 36 Papaja dhe veçoritë e saj shëruuese / Omer Yildiz
- 38 Dorëzohani fëmijëve çelësat e suksesit / Një burrë





# Mirë se vjen MUAJI I BEKUAR I Ramazanit



Erdhi muaji i Ramazanit. Erdhi që të ringjallë shpresat tona, që të na forcojë edhe më shumë besnikërinë ndaj Allahut, të na përkujtojë amanetin që Islamit t'ia rikthejmë forcën, nderin dhe krenarinë. Me fillimin e Ramazanit, rinovohen edhe një herë mendimet, frymëzohen ndjenjat, ndërsa mëshira në frekuenca të shumëllojshme shkon e bashkohet ku me ankthin, e ku me shpresën, bashkohet e thellohet në shpirt. Po, me ardhjen e tij largohen të gjitha pengesat e arritjes për tek Allahu, të gjitha paudhësitë shkatërrohen, majat kthehen në fusha, e fushat në lëndina lulësh.

Ramazani vjen me rrjedha kuptimesh dhe emocionesh, që ujin zemrat e thara dhe të etura, duke e favorizuar botën e brendshme të njerëzve për kuptime dhe koncepte të reja. Në ditët, orët dhe minutat e këtij muaji të bekuar, zemrat arrijnë kaq thellësi shpirtërore dhe bëhen aq të kthjelltë (kthjella), sa që njerëzit kurrë nuk dëshirojnë të largohen nga atmosfera e kësaj paqeje.

Për shpirtrat që ndiejnë përherë etjen për mëshirë, Ramazani është si shiu që mbërrin në zemër të tokës, vadit gjithë qenien, nga koka te këmbët, ujit ndërgjegjet që kanë filluar të thahen, zbret deri në thellësitë e ndjenjave dhe e kthen vetëdijen njerëzore në një pllajë të gjelbëruar. Aq sa të gjithë këta shpirtra që përjetësohen me ngjyrimin e minutave të kësaj pjese të bekuar të kohës zgjohen ndaj thellësive të magjishme të ekzistencës dhe s'duan të ndahen më prej kësaj klime plot hijeshi.

Në këtë mënyrë, këta njerëz të përkohshëm arrijnë në gradën e qenieve të përjetshme, ndërsa çdo sjellje e tyre e programuar sipas shpirtit të tyre të adhurimit, arrin vlera ceremonish parajse.

Gati çdo natë në Ramazan është shumë më e thellë se netët e tjera dhe me dimensione të përtejme; ndërsa ditët me atë maturinë dhe ngjyrat goditëse ndjehen si një atmosferë kuptimplote e vullnetit dhe durimit.

Shpirtrat e agjëruesve, sikur përgatiten çdo natë për një takim të ri, të emocionuar deri në ngazëllim, të sjellshëm në masë dhe të edukuar deri në habi, trokasin në dyert e mëshirës dhe shpresës. Në fytyrat e tyre shfaqen njëherësh modestia me seriozitetin, siguria me brengën, sundon të qenët që e mënjanon bindshëm të dukurit. Zemrat u rrahin me dashuri, para së gjithash për të Dashurin e vetëm të zemrës së tyre, e më pas, po për hir të Tij, për çka Ai ka krijuar.

Sytë plot magji e të mbështeturve me gjithë zemër tek Allahu, pasqyrojnë një sërë thellësish

prej së përtejmes dhe gati të gjithë këta sy shkëlqejnë me dritën e një bote të panjohur.

Kush të dojë, madje edhe në Ramazan, le të ulët e të ngrihet me smirë e urrejtje, kush të dojë të turbullohet përballë të vërtetave të besimit dhe Islamit, kush të dojë le të mallkojë dritën, kush të dojë t'i shpallë luftë mirënjohjes, tolerancës; ndërsa ne Ramazani, me gjithë dritën dhe forcën magjepsëse që zotëron, na pëshpërit me zërin shpresëdhënës pasuritë tona shpirtërore, traditën tonë të hershme; na pëshpërit dhe shpirtrat tanë të uritit i ngop me sofrat e begata, ndërsa përballë shpirtave të errët, qëndron i hapur dhe, duke i shkruar urrejtjet e armiqësitë, vazhdon të na freskojë me flladin e Xhenetit.

Myslimanët mbarë, të rinj e të vjetër, gra e burra, të pasur e të varfër, të shëndetshëm e të sëmurë, drejtues e të drejtuar, nëpunës e tregtarë, vijnë e bashkohen në klimën zbutëse, formuese e të magjishme të Ramazanit... e me një përzemërsi, pastërti e ngrohtësi, ndajnë së bashku një lumturi që vetëm krijesat qiellore e njohin. Madje, në të shumtën e rasteve, ai ka një ndikim të pabesueshëm edhe mbi masat e njerëzve që duken të pafate, të mjera e të shkreta. Është e pamundur të qëndrosh indiferent përballë Ramazanit që përfshin çdo gjë!

Ramazani, sidomos zemrat e hapura ndaj pafundësisë, i magjeps aq shumë, i ndikon aq thellë, sa që vetëm atë dëgjojnë, atë mendojnë dhe atë ëndërrojnë!

Për të vëmendshmit e këtij muaji, iftaret përmbushen me ndjenjën e adhurimit dhe thuajse bashkëngjiten me teravitë; syfyret ndërthuren me namazin e natës dhe marrin pjesë prej afritit me Mëshirëplotin. Rrugët mbushen me udhëtarët e xhamive, faltoret oshtijnë si Qabeja me tekbiër; rrugët, pazaret sikur kthehen në faltore; dhe faltorja vetë shndërrohet në Qabe.

Çdo zë, çdo lëvizje, çdo hap dhe çdo veprimtari në këtë muaj, na kujton Ramazanin në mënyrën e vet. Ndërsa ne mundohemi ta përjetojmë atë thellë në gjoksin tonë, ai, me momentet më të zjarra, na dhuron dashuri, përkushtim dhe emocion... duke i ofruar shpresë e vullnet etjes së zemrës sonë, ai i rikthen gëzimin syve të përplotur dhe buzëqeshjen fytyrave të brengosura.

Prandaj, ne nuk duam aspak që Ramazani të largohet; ne nuk duam por, sikurse çdo gjë që vjen duhet të ikë kur t'i vijë koha, edhe ai, si një i ftuar gëzimsjellës vjen e pasi qëndron njëfarë kohe largohet...dhe pas tij, vjen Bajrami si kurorëzues i vetëm i gjithë pasurive të këtij muaji magjepsës...





# Ramazani

## ARDHJA JOTE NA GËZON

Ramazan o muaj i begatë, aroma jote ndihet me muaj para mbërritjes tënde në mesin tonë. E di pse? Sepse ka zemra të përmalluara për ty; ka shpirtra të etur për "ushqimin" tënd; ka besimtarë që u mungon atmosfera jote. Ata që të duan, pyesin: Kur fillon Ramazani? Pyesin sepse ti je bërë pjesë e pandarë e jetës së tyre. Çdo ditë që kalon, aq më shumë afrohesh. Ka filluar numërimi mbrapsht. Rrjetet sociale janë të mbushur me postime të përditshme besimtarësh, që tregojnë edhe sa ditë ka mbetur nga takimi me ty. Me padurim të presim, sepse duam me shpirt të të përjetojmë. Ditët e tua kanë tjetër vlerë; netët e tua dallojnë nga netët e muajve të tjerë. Ti vjen çdo vit, por kujtimet që lë, janë të paharruara për këdo që të përjeton ty. Edhe pse që nga viti i kaluar, takimi me ty është pak i pazakontë, për shkak të pandemisë që pllakosi mbarë botën; edhe pse iftaret kolektive për shkak të ruajtjes së shëndetit, nuk organizohen, prapëseprapë, ti ke shumë për të na dhënë, e ne kemi shumë nevojë për një muaj si ty.

Ramazan, ti je një bekim për botën mbarë. Një vit pa ty, do ishte pa kuptim, do ishte pa shije, do ishte i mangët. Ti je një dhuratë e Allahut të Lartësuar, dërguar të gjithë besimtarëve. Ti i jep një tjetër kuptim jetës sonë. Me ardhjen tënde zgjohemi edhe ne nga gjumi i gjatë i shkujdesjes dhe harresës. Vetëdijesohemi për gjendjen ku ndodhemi dhe fuqizohet dëshira jonë për t'u përmirësuar dhe për t'u afruar më pranë Zotit tonë. Kur ti je në gjirin tonë, besimi ynë vetëm shtohet; ndihemi më të devotshëm, më të dashur me njëri-tjetrin; solidarizohemi me të varfrit dhe të vobektët dhe me aq mundësi sa kemi u qëndrojmë pranë, duke ua lehtësuar sadopak vështirësitë. E kush prej nesh nuk ka vështirësi e probleme, por Allahu është shpresa jonë e vetme dhe e vetmja derë ku trokasim. Trokitjet tona drejt Tij, shtohen më së tepërmi gjatë prezencës tënde ndër ne. Pikërisht Allahun e ndiejmë më afër, atëherë kur lutjet tona janë më të forta.

Kemi nevojë që të na freskosh me fladin tënd. Ti je i mbushur me mirësi të shumta, saqë nuk dimë kë të veçojmë. Na ka marrë malli t'i nisim ditët tona me syfyret e tua të

begata, e t'i përmbylim ditët tona me iftaret e tua plot shpërblim e shpresë. Ti na ripërtërin besimin, durimin, vullnetin, vendosmërinë, devotshmërinë, dëshirën e zjarrtë për punë të mira dhe për t'i qëndruar sa më larg haramëve dhe ndalesave. E kjo nuk është pak. Sado që përpiqemi në muajt e tjerë, e kemi të pamundur që t'i realizojmë të gjitha këto, por brenda teje, e kemi shumë të lehtë, ndoshta ngaqë edhe i mallkuari shejtan, është i lidhur dhe nuk e ka fuqinë aq sa për të na nxitur për keq, apo për ta na ndaluar nga e mbara. Ah çfarë muaji që je! Në ditët e tua, Allahu paralizon shejtanin dhe ia ul nivelin e ndikimit në jetën e besimtarit. Sikur vetëm këtë mirësi të kishe, do të mjaftonte, por jo. Një muaj si ti meriton më shumë, prandaj dhe Zoti Bujar të ka mbushur me mirësi e mirësi, që s'kanë të numëruar, njëra më me vlerë se tjetra. Dhe të gjitha në dispozicion të besimtarëve. Arsyet për të të pritur ty me zemër që rreh fort, padyshim që janë të shumta, por mbi të gjitha ti je miku i Allahut. E neve na takon të të respektojmë e të të nderojmë siç të ka hije.

Ti je si një ilaç apo melhem për shpirtat tanë të plagosur. I jemi mirënjohës Allahut të Madhëruar që mendon gjithmonë për ne njerëzit (krijesën më inteligjente dhe më të përsosur në mesin e krijesave të Tij), na i di më mirë se çdokush tjetër nevojat tona, qoftë ato fizike, qoftë ato shpirtërore dhe na furnizon me ushqimet përkatëse. E ti Ramazan, je serumi që injektohesh në damarët tanë; që na pastron nga mikrobet e vesveseve dhe që ngre në nivele të larta normat e moraleve dhe sjelljeve shembullore. Ti tashmë e ke marr rrugën dhe shumë shpejt do të jesh në pragjet tona. Të jesh i sigurt se me miliona do të jenë ata që do të mirëpresin, që do të të hapin jo vetëm dyert e shtëpive, por mbi të gjitha do të të hapin dyert e zemrave dhe të shpirtit. Mezi presim të na buzëqeshësh me ardhjen tënde. Në këto kohë, kur pandemia globale gllabëron jetë njerëzish çdo ditë, lusim Zotin (Jetë-Dhënësin dhe Jetë-Marrësin), të mos na privojë nga takimi me ty, nga qëndrimi me ty, nga përfitimi prej teje dhe nga shpërblimi i çdo pune e adhurimi që i kemi vënë për qëllim vetes për ta kryer gjatë ditëve e netëve të tua! Ardhsh i mbarë o Ramazan! Amin





## 1

## VIZITË PUNE NË MYFTININË E POGRADECIT

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, zhvilloi një vizitë pune në Myftininë e Pogradecit. Kryetari u prit nga Myftiu i Pogradecit, z. Namik Mahmutllari, dhe imamë të xhamive të ndryshme të myftinisë. Kryetari Spahiu falënderoi myftiun dhe imamët për punën e deritanishme dhe u shprehu atyre gjithë mbështetjen e tij personale dhe të institucionit për mbarëvajtjen e punëve në shërbim të përhapjes së mesazhit të bukur të fesë islame.

Më pas, Kryetari mbajti hutben e xhumasë në xhaminë "Ebu Bekr" ku ndau mesazhin e tij me besimtarët e pranishëm.

Në këtë vizitë, Kryetari Spahiu u shoqërua nga z. Taulant Bica, Nënkryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, i cili gjithashtu mbajti hutben në xhaminë "Bilal".







## 2

## PJESËMARRJA NË WEBINARIN E ORGANIZUAR NGA KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mori pjesë në webinarin e organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, me temë: "Drejt një dialogu më të madh ndërkulturor, ndërbesimtar dhe ndërfetar në Ballkanin Perëndimor".

Ky webinar, i zhvilluar online nëpërmjet platformës "zoom", mbledhi së bashku përfaqësues të Ambasadave në vendin tonë, përfaqësues të komuniteteve fetare dhe partnerë të shoqërisë civile në rajon, të cilët paraqitën mendime, shkëmbyen opinione dhe ndanë mesazhe të ndryshme sensibilizimi mbi nivelin e respektimit të lirisë së fesë, dialogut ndërkulturor, ndërbesimtar dhe ndërfetar në vendet e rajonit.

Në fjalën e tij përshëndetëse, kryetari i KMSH-së, z. Spahiu, pasi falënderoi organizatorët dhe pjesëmarrësit për mundësimin e këtij webinari, u ndal në modelin unik të bashkëjetesës dhe harmonisë ndërfetare e ndërkulturore që vendi ynë i përcjell, jo vetëm rajonit por edhe botës mbarë, duke e ilustruar fjalimin e tij me ajete të ndryshëm nga Kur'ani Famëlartë dhe shembuj nga jeta e Profetit Muhamed (a.s.).

## 3

## MBLIDHET BORDI I PRESIDENCËS I KËSHILLIT NDËRFETAR

Bordi i Presidencës i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë ka mbajtur më dt. 3 shkurt 2021, mbledhjen e radhës dhe të parën për këtë vit. Kështu në mbledhjen e zhvilluar, merrnin pjesë krerët e pesë komuniteteve fetare në vend, bashkëdrejtues dhe të KNFSH-së, Sekretari i Përgjithshëm dhe përgjegjësja e Financave në KNFSH.

Takimi ndërfetar i mbajtur në Arqipeshkvinë e Tiranës është hapur nga Mons. George Frendo, njëkohësisht dhe kreu në detyrë i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, i cili ia ka dorëzuar detyrën e kreut të Këshillit Ndërfetar H. Dede Edmond Brahimajt, i cili do të kryesojë presidencën e KNFSH-së për gjatë vitit 2021.

Anëtarët e Këshillit të Presidencës gjatë kësaj mbledhjeje kanë diskutuar edhe për disa çështje të rëndësishme lidhur me angazhimet e KNFSH-së në vazhdimësi, si dhe për problematika akoma pa zgjidhje nga ana e shtetit shqiptar, siç është çështja e pronave të pakthyera gjatë këtyre tre dekadave liri besimi.





## 4

**ZHVILLOHET CEREMONIA E NDARJES SË ÇMIMEVE TË KONKURSIONIT TË TEFSIRIT**

Ceremonia e ndarjes së çmimeve, për tre vendet fituese të këtij konkursi, është zhvilluar më datë 11.02.2021 në ambientet e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, ka mirëpritur fituesit e këtij konkursi, si dhe drejtues të departamentit dhe klubit studentor, ku ka vlerësuar punën dhe aktivitetet studentore në fushën e shkencave islame, duke nxitur dhe promovuar leximin e librave të trashëgimisë islame në gjuhën shqipe, jo vetëm për studentët e departamentit, por edhe për mbarë rininë shqiptare.

Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Islame, Dr. Genti Kruja, ka vlerësuar nismat studentore në këtë fushë, si shumë të rëndësishme për jetën akademike të një universiteti, si dhe ka falënderuar Komunitetin Mysliman të Shqipërisë për mbështetjen me librat e dhuruar për fituesit e këtij konkursi. I pranishëm në këtë aktivitet ishte dhe drejtori i Kulturës z. Dorian Demetja dhe lektorja pranë Departamentit të Shkencave Islame, Bedër, znj. Lorela Shehu.

## 5

**KONFERENCA KOMBËTARE, ME TEMË: "BESIMET FETARE KUNDËR TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE"**

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mori pjesë në konferencën kombëtare, me temë: "Besimet fetare kundër trafikimit të Qenieve Njerëzore".

Kjo konferencë u organizua nga Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë dhe Caritasi Shqiptar.

Në të morën pjesë krerët e besimeve fetare, përfaqësues të ambasadave të akredituara në Tiranë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe të institucioneve të shtetit shqiptar.







## 6

## SIMPOZIUMI NDËRKOMBËTAR "ROLI I EDUKIMIT FETAR NË PROMOVIMIN E NJË KULTURE TË PËRPARIMIT DHE ZHVILLIMIT"

Në këtë simpozium të organizuar nga Departamenti i Shkencave Islame në KU "Bedër", morën pjesë drejtues të lartë institucionesh fetare. Veçojmë këtu Kryetarin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, si dhe një grup studiuesish nga bota Islame, si: Dr. Mohamad Bachari, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Botëror të Komuniteteve Myslimane, Emiratet e Bashkuara Arabe, Dr. Mustafa Cerić, President i Kongresit Botëror Boshnjak, Bosnjë & Hercegovinë, H. Resul Rexhepi, Ish Sekretari i Përgjithshëm i BIK, Kosovë, Dr. Naser Ramadani, Fakulteti i Shkencave Islame, Maqedonia e Veriut, Dr. Jamal el Seferty, Departamenti i Shkencave Islame, KU Bedër, etj.

Në fjalën e tij, Kryetari Spahiu, theksoi rolin e arsimit fetar në promovimin e kulturës së përparimit dhe zhvillimit të shoqërisë.

Simpoziumi, i cili u zhvillua online, vijoi me tej me referimin e të lartpërmendurve, të cilët bënë një pasqyrim të situatës së arsimit fetar në shtetet përkatëse, duke theksuar arritjet e deritanishme, problematikat e hasura ndër vite, si dhe të ardhmen e afërt në këtë kontekst.

## 7

## VIZITË PUNE NË MYFTININË LUSHNJE

Në kuadër të një turi takimesh në myftinitë e rretheve, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, së bashku me Kancelarin, z. Ylli Cikalleshi, zhvilluan një vizitë pune në Myftininë Lushnjë.

Pas takimit me Myftiun e Lushnjës, z. Gramoz Blliku, ku dy drejtuesit e lartë të KMSH-së e përgëzuan për punën e bërë në këtë myftini, patën edhe një takim me të gjithë imamët e Myftinisë Lushnjë.

Qëllimi i këtij turi takimesh, që drejtuesit më të lartë të KMSH-së po zhvillojnë në rrethe, është mbështetja për myftinjtë, imamët dhe gjithë personelin mbështetës të institucionit në bazë, duke krijuar një sinergji në funksion të një qëllimi sa të madh aq edhe të përbashkët, përhapjen e mesazhit të drejtë e të pastër të Islamit te besimtarët.



# Urrejtja e verbër

Urrejtja është ndër karakteristikat e njeriut. Ajo lind dhe zhvillohet së bashku me njeriun, ashtu si edhe shumë tipare të tjera të tij. E ndikuar nga kushtet dhe rrethanat, në të cilat gjendet njeriu, nga edukata dhe kultura që ka marrë përgjatë jetës, ajo mund të fuqizohet ose frenohet e kontrollohet për t'u drejtuar në kahun e duhur.

Njeriu nuk mundet të mos urrejë. Ai nuk mund të çlirohet plotësisht prej ndjenjës së urrejtjes. Do të ishte fatale nëse do të çlirohej prej saj dhe nuk do të ndjente urrejtje aspak, për çfarëdo që ndodh përreth tij. Fjala është për urrejtjen ndaj së keqes. Njeriu duhet ta urrejë të keqen që endet brenda vetes së tij. Urrejtja ndaj së keqes nxit reagimin dhe luftimin e saj. Njeriu nuk mund të pajtohet me të keqen dhe ta pranojë si normalitet, e as të ecë përkrah saj pa u shqetësuar aspak. Kjo është urrejtja që njeriu duhet ta ushqejë vazhdimisht si shenjë e të qenët gjallë.

Por, krahas kësaj ekziston edhe

urrejtja e verbër. Te njeriu mund të zhvillohet edhe urrejtja ndaj virtyteve. Te njeriu nuk mund të bashkëqëndrojnë urrejtja ndaj së keqes me urrejtjen ndaj virtyteve. Nëse do të na duket sikur po ndodh, atëherë është krejt e sigurt se kemi të bëjmë me një qenie hipokrite, që së jashtmi shpërfaqet si urrejtës i së keqes, e së brendshmi i vlon kazani i urrejtjes ndaj çdo virtyti.

Urrejtja e verbër është gjendja në të cilën njeriu i është nënshtruar së keqes në mënyrën më të keqe të mundshme. Tjetërsimi i njeriut, në këtë gjendje, është kaq i frikshëm, saqë kush përpihet prej saj jeta i kthehet në një tragjedi, jo vetëm për atë që është përpirë por edhe për njerëzit dhe vendin ku ai gjendet.

Urrejtja e verbër urren armike e virtyteve dhe e çdokujt që është lidhur me to. Për urrejtjen e verbër virtytet janë ndërtesa që duhet rrënuar e shembur, pasi bukuria e tyre është lëbyrëse për sytë e errësuar nga urrejtja. Lëbyrja nuk durohet dot,

sepse këto sy janë përshtatur për të jetuar vetëm në errësira llagëmesh e gjirizesh. Shkëlqimi i virtyteve i neverit, sepse te drita e virtyteve ata shohin lakuriqësinë e ligësisë së tyre. Në mbretërinë e ligësisë nuk ka vend për virtyte, prandaj urrejtja e verbër kërkon të shuajë çdo gjurmë që kanë lënë virtytet, të rrënojë çdo ndërtesë që, në çdo gur e në çdo mistri baltë apo llaç, mban aromë virtyti.

Urrejtja e verbër ushqen mendjemadhësinë dhe fodullëkun, dy nga shkatërruesit e vlerave njerëzore. Njerëzit që urrejnë verbërisht janë përbeuar të ndjekin me fanatizëm bindjen e patundur se janë superiorë në raport me pjesën tjetër të njerëzve. Mbajtja me të madh, duke i parë gjithë të tjerët si milingona të shushatura dhe duke i konsideruar si sende të pavlera, është shprehje e qartë e urrejtjes që, kjo kategori, ka për thjeshtësinë, butësinë, mëshirën, përdëllimin, përkujdesjen pa asnjë qëllim përfitimi ndaj të varfërve, ndaj të pamundurve.





Urrejtja e verbër ushqen përcëimin ndaj të ashtuquajturve inferiorë prej saj. Përçmon çdo përçues të virtyteve, qoftë edhe një grimcë prej tyre sikur të përçojë. Përçmon kategori të caktuara të shoqërisë, duke iu vendosur me të padrejtë llogape ofenduese, denigruese dhe zhvlerësuese, për t'i bërë të ndihen keq me mënyrën e jetesës që kanë zgjedhur të bashkëndajnë ditët e kësaj jete, mënyrë jetese e ngritur mbi virtytet.

Urrejtja e verbër nxit dhunën në të gjitha përmasat e saj. Urrejtja e një populli ndaj një populli tjetër është bërë shkas për luftëra e masakra mbi njerëz civilë e të pafajshëm, pleq, gra, fëmijë. Kushdo që pushtohet nga urrejtja e verbër nuk njihet me asnjë ndjenjë njerëzore. Shndërrohet në kuçedër të etur vetëm për gjak viktimash pa pyetur për drejtësi, ligje kombëtare apo ndërkombëtare, morale, anë njerëzore...

Urrejtja e verbër nxit dhe nder zjarrin e konflikteve midis njerëzve,

ndez zjarrin e hakmarrjes dhe nuk lejon që problemet që kanë njerëzit të zgjidhen ashtu siç është e udhës, me mirëkuptim e drejtësi. Ajo i kontribuon thërrmimit të kohezionit të bashkësisë së njerëzve, të cilët, në vend që ta shohin njëri-tjetrin si pjesë e një të tërë, e shohin njëri-tjetrin si rivalë e armiq të përbetuar, që si mision kanë të shkatërrojnë kundërshtarët e tyre. Kjo nuk lejon që njerëzit t'i shtrijnë njëri-tjetrit dorën e paqimit dhe bashkëpunimit në të mira. Po kështu nuk lejon që njerëzit t'i gjenden njëri-tjetrit pranë në ditë të vështira. Urrejtja e verbër kontribuon në thërrmimin e bashkësisë njerëzore, dhe ushqen largimin e vazhdueshëm nga jeta e virtytshme, derisa, në emër të urrejtjes, të mos merret fare në konsideratë çfarë thotë e mira, e drejta për të vepruar në jetën e përditshme në raport me veten dhe me të tjerët.

Urrejtja e verbër nuk e lë të qetë e të paqte as të zonë. Ajo vepron si

turjelë të çdokush që e ka strehuar në qenien e vet. Këta njerëz nuk gjejnë asnjëherë paqe, por gjithë kohën janë në garë me të keqen. Mendja e tyre punon vetëm si e si të zhbëjë çdo të mirë që ngrihet me mund e me sakrificë. Dhe për këtë nuk ndalen para asnjë norme, vlere, parimi apo virtyti.

E vetmja forcë që mund ta ndalë urrejtjen e verbër është një forcë më e madhe se ajo. Dhe kjo forcë është vullneti për të triumfuar mbi të keqen dhe ushqyesit e saj, në mënyrë që të mos tërhiqesh në rrjetën e kësaj merimange helmuese dhe të tretesh pak nga pak prej helmit të saj të fuqishëm. Vetëm vullneti dhe durimi për të mposhtur gjakun që zien kur errësohen sytë është rruga që na çliron nga pasojat e paparashikuara të kësaj urrejtje. Kësisoj duhet kultivuar urrejtja ndaj së keqes e dashuria ndaj virtyteve, që urrejtja e verbër të qëndrojë larg, por edhe në u afroftë të jemi gati për ta mposhtur në ligësinë e vet.

PROBLEMI NUK ËSHTË  
**MUNGESA E MODERNIZIMIT**  
PROBLEMI ËSHTË  
**MUNGESA E IDENTITETIT**





Gjendja e njeriut pasqyrohet në atë se ai në çdo kohë e në çdo vend mërzhitet prej së vjetrës dhe priret e nxiton për tek e reja. Ama është detyrë për të që të qëndrojnë te humanizmi i tij, të përmbushë kuptimet e tij, të plotësojë kërkesat e tij dhe të mos mërzhitet me to, sado i vjetër që të bëhet shoqërimi i njeriut me humanizmin e tij. Madje njeriu nuk do të mund të jetonte veçse me këtë angazhim nëpërmjet kryerjes së kësaj detyre.

### **Midis së vjetrës dhe së resë**

Lidhja me identitetin njerëzor është pikënisja dhe baza. Kurse orientimi drejt interpretimit, zhvillimit, novacionit dhe përtëritjes së mënyrave të reja për jetën duhet të realizohet brenda këtij identiteti dhe ato duhet të jenë për hir të shërbimit ndaj tij dhe mbrojtjes së tij.

Megjithatë, problemi i njeriut të civilizimit modern është se ai njihet e familjarizohet gjithmonë me çdo gjë të re, ndaj së cilës priret

nefsi i tij, madje edhe sikur ai, për të, ta tejkalonte vetveten dhe të mohonte identitetin e vet. Si rrjedhojë, ai bie në konflikt me humanizmin e tij dhe bie në një dyzim shkatërrimtar midis kërkesave të qëndrueshme të identitetit të tij dhe midis fantazive të ripërtërira të tij. Që të kurohet ky problem kërkohet nga ne që, të parin e hapave të metodës së planifikuar për ripërtëritjen e jetës sonë, të bëjmë njohjen e identitetit tonë dhe pastaj në vijim ripërtëritjen e lidhjes me të dhe kapjen fort pas kërkesave esenciale të tij.

### **Modernizimi dhe origjinaliteti**

Duke parë se peshorja e fjalës sime, lidhur me dy polet e modernizimit dhe të origjinalitetit, është Islami, atëherë identiteti, i cili do të jetë objekti i qasjes sime në trajtimin e kësaj çështjeje, është adhurimi i njeriut ndaj Allahut. Megjithatë, ndodhet një bashkues i përbashkët midis myslimanëve dhe jomyslimanëve për të



bashkëpunuar në zgjidhjen e këtij problemi; ai bashkues është identiteti njerëzor, sepse Allahu nuk i njoftoi robt e Tij rreth kësaj feje, qysh prej fillimit të ekzistencës njerëzore, dhe as nuk i obligoi ata me ndjekjen e bazave të besimit dhe me dekretet e normat etike, veçse me qëllim që ajo të jetë mbrojtësja e kuptimeve dhe e vlerave njerëzore, të cilat e dallojnë njeriun prej krijesave të tjera.

Kështu, diskutimi im, lidhur me Islamin dhe me atë çfarë mund të ketë prej gjërave të qëndrueshme dhe atyre të ndryshueshme, do të jetë veçse një diskutim rreth murit, i cili i ruan kuptimet njerëzore prej qenies së tyre të kota dhe prej përpjekjes për t'i asgjësuar ato.

Unë nuk kam gjetur brenda strukturës së të vërtetave islame, e cila përbëhet prej parimeve shkencore të besimit dhe prej normave etike, veçse vlerat e qëndrueshme, të cilat nuk ndryshojnë, sepse gjithçka që gjendet në to janë realitete; dhe realitetet - sipas logjikës - nuk pranojnë asnjë zhvillim apo ndryshim. Megjithatë, krahas funksionit të këtyre realiteteve të qëndrueshme, ato e nxisin njeriun mysliman për të ushtruar jetën e tij ideologjike, civilizuese dhe ekonomike, në përgjithësi, për ripërtëritjen e mënyrave në përputhje me një sistem të qëndrueshëm të përcaktuar, të cilin ta administrojnë e ta sundojnë ato realitete të pandryshueshëm. Është e rëndësishme që ta dimë se këto ndryshime ideologjike dhe civilizuese nuk janë të brendshme në ndonjërin prej atyre realiteteve, por ato janë prej rrjedhøjave dhe rezultateve të tyre. Prej urtësive të shndritshme të Allahut xh.sh. është se Islami nuk mund t'i nxisë myslimanët për ripërtëritje të vazhdueshme në jetën e tyre, veçse në qoftë se ajo është në vetvete - domethënë e mishëruar në realitetet e tij - e stabilizuar e përcaktuar dhe qëndron e lartësuar mbi zhvillimin dhe ndryshimin.

Kjo përmbledhje, të cilën unë po e vendos para lexuesit, nuk është e zgjeruar në sqarimin e kësaj të vërtete, dhe nuk parashtrohet veçse me anën e disa shembujve të shkurtër praktikë. Shpresoj që kjo të jetë e mjaftueshme për shpjegimin e kësaj së vërtete të rëndësishme.

Së pari, shikoni këtë shembull! Nga parimet më të rëndësishme të Islamit është rrotullimi i dekreteve të tij mbi ruajtjen e interesave të njerëzve, që në rendin e tyre të respektohet shkalla e prioriteteve në

formën vijuese:

E para, është ruajtja e interesit të fesë. E dyta, është ruajtja e jetës. E treta, mendja. E katërta, familja. E pesta, pasuria.

Sigurisht dhe padyshim, ky parim është një interpretim i një realiteti të qëndrueshëm, i cili sfidon çdo zhvillim apo ndryshim të tij. Megjithatë ai nxit një seri zhvillimesh të pafundme brenda kuadrit të marrëdhënieve me jetën. Ai parim kërkon prej nesh ruajtjen e interesit të mendjes sa herë që është në harmoni e në përputhje me interesin e jetës. Por vetë ai parim bën të detyrueshme për ne që ta shkelim e tejkalojmë interesin e mendjes, në qoftë se në të do të kishte kërcënim ndaj interesit të jetës.

Gjithashtu ky parim, lidhur me interesin e pasurisë, na kërkon neve ta ruajmë pasurinë nëpërmjet fitimit, zhvillimit dhe kursimit me të gjitha mjetet dhe mënyrat e mundshme, për sa kohë që ekziston koordinimi dhe proporcioni midis kërkesave të kësaj ruajtjeje dhe asaj të katër interesave të tjerë, të cilët e paraprijnë atë në prioritet dhe në rëndësi. Në qoftë se ka konflikt midis kërkesave të ruajtjes së pasurisë dhe midis secilës prej atyre interesave të tjera, atëherë duhet që ne ta tejkalojmë interesin e pasurisë në atë masë që bën të mundur realizimin e koordinimit midis asaj dhe atyre gjërave prej interesave të tjera me të cilat bie ndesh. Ky parim i qëndrueshëm nxit një lëvizje të vazhdueshme në përtëritjen e marrëdhënieve bashkëvepruese midis këtyre interesave sa herë që tek ato ndodh ndonjë defekt apo çrregullim. Sigurisht është shumë e qartë se kjo lëvizje e rregullt nuk është vetëm se një hije e atij parimi të qëndrueshëm, dhe ajo nuk është vetë parimi, siç e mendojnë disa sipërfaqësorë.

Një shembull tjetër: Midis parimeve dhe dekreteve të qëndrueshme është ndalimi i spekulimit dhe i mashtrimit në transaksionet financiare dhe ndalimi i veprimeve financiare që çojnë në shtimin e parave prej parave pa i lidhur ato me avantazhet e përfitimet (domethënë, me kamatë). Disiplina nëpërmjet këtij parimi të qëndrueshëm është që të hapë rrugën për tek alternativat e shumta të ndryshme në aspektet e veprimeve financiare, të tilla si: Aktet ligjore lidhur me fitimin dhe spekulimin, si dhe lidhur me llojet e shumta të kompanive dhe të çfarëdo gjëje tjetër që do të mund të përtërinin veprimet



financiare, duke qëndruar larg kamatës, spekulimit dhe mashtrimit. Ai është një parim i qëndrueshëm në vetvete, por ai nxit për të modernizuar mënyra e zhvillime të reja prej marrëveshjeve ekonomike dhe financiare.

Një shembull tjetër: Midis parimeve të qëndrueshme është kushtëzimi i drejtësisë për personat që marrin poste të larta të ndjeshme si, në gjykatë e në vende të tjera të ngjashme; dhe kushtëzimi i drejtësisë për njerëzit që dëshmojnë nëpër gjykata. Drejtësia te njeriu është që ai të mos kryejë hapur një veprim i cili do t'i prekte burrërinë edhe nëse do të ngulmonte në bërjen e atij veprimi. Por cila është gjëja që prek burrërinë? Ajo është ngulmimi në kryerjen e diçkaje prej veprave të ndaluara, ose dalja kundër zakoneve dhe traditave të ndjekura nga njerëzit. Ai është një parim dhe një dekret i qëndrueshëm e i pandryshueshëm në Sheriat. Por, siç e shikoni, ai është i lidhur me ndryshimet e traditave shoqërore. Prej kërkesës së këtij parimi ishte, për shembull, heqja e burrërisë prej dikujt që vishte pantallona të ngushta dhe që ecte i zhveshur midis njerëzve nëpër rrugët e përgjithshme para disa shekujve, për shkak se kjo përbënte dalje kundra zakoneve dhe traditave, që ndiqeshin në atë kohë. Por pikërisht këto veshje sot janë në harmoni të plotë me burrërinë dhe nuk ndalojnë për të dhënë dëshmi dhe as për të marrë ndonjë post të lartë të ndjeshëm. Imam Shatibiu - që është, ashtu siç e dini, njëri prej dijetarëve më të shquar të Granatës - thotë: "Dalja me kokë të zbuluar e një personaliteti mysliman nëpër rrugë të përgjithshme e në vende publike, në Lindje, bën që atij t'i bie burrëria dhe i refuzohet dhënia e dëshmisë si dhe i ndalohet marrja e ndonjë posti të lartë në gjykatë e në vende të tjera të ngjashme. Por, dalja e këtij personaliteti mysliman tek ne në Perëndim, me këtë pamje, nuk e dëmton burrërinë dhe as nuk ndikon në saktësinë e dëshmisë dhe as nuk ndalohet për të pranuar ndonjë post.

Kështu Islami e bëri traditën e ndjekur shoqërore një peshore për mirësjellje me të cilën duhet të pajiset e dallohet myslimani dhe madje çdo njeri; është ajo e cila e bën të fitojë burrëri sipas terminologjisë së fikhut, me kusht që tradita të mos kundërshtojë një parim tjetër të qëndrueshëm prej parimeve islame.

### **Nevojat e njeriut dhe Islami**

Të gjitha parimet dhe dekretet e Islamit janë të qëndrueshme e nuk mund të shfuqizohen nga rrymat e modernizimit. Shkaku i qëndrueshmërisë së tyre është se ato u përgjigjen kërkesave dhe nevojave të qëndrueshme njerëzore. Në qoftë se do të zhvillohej humanizmi i njeriut, edhe këto dekrete e parime do të zhvilloheshin bashkë me të. Por rruga e zbatimit të këtyre dekretëve dhe parimeve i nënshtrohet vazhdimisht - ashtu siç e pamë - risisë dhe zhvillimit. Traditat e shëndosha shoqërore kanë pushtet të vazhdueshëm mbi të.

Pjesa e mbetur e fjalës është se të gjitha dekretet që përmban Islami janë të qëndrueshme dhe të pandryshueshme. Por vërtetësia e kësaj fort pas dekretëve të tij nxit zhvillimin e vazhdueshëm me kusht që kjo të realizohet nën inspektimin dhe kontrollin e vazhdueshëm të atyre dekretëve. Argument i qartë për këtë është se myslimanët që e përqaftuan Islamin në Epokën e Vulës së Profetëve, Muhamedit a.s., dhe të cilët ishin grupe prej fiseve nomade arabe, i zhvilluan për një periudhë gjysmë shekullore të gjitha mënyrat dhe stilet e jetës së tyre më shumë se sa i zhvilluan ato mënyra myslimanët e ndriçuar në këto katër shekujt e fundit; dhe ai zhvillim i shpejtë nuk i shtyu ata për të zhvillimi i asnjërit prej dekretëve të Islamit. Sekret i zhvillimit të tyre ishte forca e qëndrësës dhe vazhdimësisë e kësaj së tyre pas atyre dekretëve.

Kështu, myslimanët, sa më shumë të fitojnë prej parimeve të Islamit dhe sa më me ngulm të kapen pas tyre, aq më shumë dhe, pikërisht, në atë masë ato parime do të hapin për ta horizontet e zhvillimit dhe të modernizimit, duke i shtyrë me shpejtësi drejt tyre brenda sistemit dhe planimetrisë. A e keni parë makinën në të cilën ne hipim? Islami është si kjo makinë. Sa më shumë që ne të kujdesemi për rregulloren e saj dhe për pajisjet e saja të brendshme, aq më shumë ajo të transporton dhe të çon tek objektivat e tua. Ndërsa, në qoftë se ti do të lodheshe e mërziteshe prej zbatimit të rregullores së saj dhe fillon të bësh gjëra të kota me të, sigurisht ajo do të ndalonte dhe, si rrjedhojë, ajo do të të ndalonte edhe ty duke të të lënë prapa, duke mos arritur tek aspiratat e tua.

**Shqipëroi nga arabishtja: Jusuf Salkurti**



# AGJËRIMI I MUAJIT *të Ramazanit*

Agjërimi i muajit të Ramazanit është detyrim (farz) për secilin mysliman të rritur dhe të aftë mendërisht e fizikisht, për çdo vit, gjatë tërë jetës. Farz është, po ashtu, agjërimi kaza i ditëve të paagjëruara të Ramazanit me arsye ose pa arsye të justifikueshme. Kështu, nëse dikush nuk agjëron, ose e prish atë sepse është i sëmurë, ose duke udhëtuar, do t'i zëvendësojë pas Ramazanit në një kohë të përshtatshme, një për një, ditët e paagjëruara. Kështu vepron edhe femra, e cila gjatë Ramazanit është me të përmuajshmet e grave ose lehonë.

Sipas kalendarit hënor, muaji i Ramazanit është muaji i nëntë i vitit. Është muaji të cilin Allahu i Lartësuar e ka përmendur në Kur'an si njoftim për fillimin e zbritjes së tij në këtë muaj dhe si porosi për agjërimin e tij, duke thënë:

"Muaji i Ramazanit është ai në të cilin ka zbritur Kur'ani, që është udhërrëfyes për njerëzit dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i së vërtetës nga gënjeshtria). E pra, kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë!" (Bekare, 185).

Nga Suneti - Tradita e Pejgamberit a.s., veçojmë:

Pejgamberi a.s. ka thënë:

"Islami është ngritur mbi pesë shtylla: Dëshmia se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguar i Tij, falja e

namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe vizita e Qabesë për ata që kanë mundësi." (Transmetojnë Buhariu, Muslimi, Tirmidhiu).

Nga tradita profetike duhet të përmendim edhe faktin se Muhamedi a.s., në veçanti që nga koha kur agjërimi u bë farz, i gëzohej tej mase ardhjes së Ramazanit, madje shokëve të tij sikur u jepte sihariq duke u thënë:

"Ju erdhi Ramazani, muaji me plot begati, Allahu jua ka bërë detyrim agjërimin e tij, në të hapen dyert e Xhenetit, ndërkaq mbyllen ato të Xhehenemit, në të mbyllen (prangosen) shejtanët. Në të ka një natë që është më e vlefshme sesa një mijë muajt tjerë!" (Transmetojnë Nesaiu, Bejhekiu dhe Ahmedi nga Ebu Hurejreja).

Dhe jo vetëm kaq, por ky muaj, krahas begatisë së agjërimin që iu dhurohet besimtarëve, cilësohet edhe si muaj i lutjeve dhe pendimit, muaj i durimit dhe i shpërblimeve, i paqes dhe i dashurisë mbarë njerëzore. Ai është muaji i bujarisë, mëshirës dhe i humanizmit. Andaj, besimtari kurrë nuk është më i sinqertë, më bujar dhe më i dëlirë sesa në këtë muaj!

Përveç agjërimin të Ramazanit, është farz të kryhen edhe kefaretet, të cilat kryhen përmes agjërimin, si kefareti për ndonjë ditë të paagjëruar të Ramazanit pa justifikim ligjor, apo edhe kefareti kur njeriu e vret dikë pa dashje, kefareti i dhjarit, etj.

## KUSHTET E DETYRUESHMËRISË SË AGJËRIMIT

Sikurse tek adhurimet e tjera, natyrisht që edhe tek agjërimi, që të jetë i detyrueshëm, duhen plotësuar disa kushte:

1. Islami - Që dikush ta ketë farz - detyrim agjërimin, duhet që, paraprakisht, të jetë besimtar i fesë islame, pra të jetë mysliman, sepse agjërimi nuk është i detyrueshëm për jomyslimanin.

2. Të jetë në moshë të rritur - në moshën e pjekurisë gjinore, e cila më së paku llogaritet kur mbush 15 vjeç. Ç'është e vërteta, për shumicën e adhurimeve kushtëzohet plotësimi i moshës madhore, kështu që ai që nuk e ka arritur këtë moshë, nëse agjëron, ka sevape dhe shpërblehet, por në qoftë se nuk agjëron nuk dënohet.

3. Të jetë mendërisht i shëndoshë, përkatësisht të mos jetë i sëmurë mendor.

4. Të jetë fizikisht i shëndoshë, përkatësisht të mos jetë i sëmurë saqë të mos jetë në gjendje të përballojë agjërimin. Mirëpo, ditët e paagjëruara duhet t'i kompensojë, kur të shërohet.

5. Kusht është edhe që të jetë i vetëdijshëm për detyrueshmërinë e agjëritit si mysliman dhe i njoftuar për kohën e Ramazanit. Kjo ka të bëjë më tepër me një person mysliman që jeton në një shtet në të cilin nuk ka myslimanë.

6. Të mos jetë udhëtar në largësi prej tri ditësh udhëtimi në këmbë, apo 90 km, sepse udhëtarit të tillë i lejohet të mos agjërojë, me kusht që ato ditë t'i kompensojë, kur të kthehet në shtëpi.

7. Femra të jetë e pastër nga zakonet (të përmuajshmet e grave dhe periudha e lehonisë pas lindjes). Në qoftë se nuk është e pastër, ajo e ka të ndaluar agjërimin, kurse ditët e paagjëruara duhet t'i kompensojë pasi të pastrohet nga zakonet e grave dhe periudha e lehonisë pas lindjes.

### Çfarë e prish agjërimin?

Si çdo adhurim tjetër, agjërimi i Ramazanit dhe agjërimet e tjera në përgjithësi kanë disa rregulla, të cilat agjëruesi duhet t'i respektojë. Ndërkaq, nëse agjëruesi nuk e respekton ndonjërin prej tyre, atëherë agjërimi tij prishet dhe është i pavlefshëm. Por, para se të rendisim disa nga rastet që e prishin agjërimin, le të përmendim se këto kanë të bëjnë me dy lloje situatash:

1. Situata që e prishin agjërimin dhe që kërkojnë që ai vetëm të bëhet kaza - kompensohet.

2. Situata që e prishin agjërimin dhe kërkojnë edhe kazanë edhe kefaretin - kundërshtëpërlblim e tij.

### 1. Rastet kur agjërimi prishet dhe duhet bërë kaza

Para se t'i përmendim këto raste, le të shpjegojmë se ç'do të thotë "kaza"?

Agjërimi i një dite të prishur me arsye e të cilën e agjëron në një kohë tjetër, quhet kaza (origj. arab. "kada"). Pra, sa ditë që të kanë mbetur pa i agjëruar, e që duhen agjëruar në një tjetër kohë, ditë për ditë, kjo periudhë kohore quhet kaza.

### Janë shumë raste të kësaj natyre, por ne do përmendim vetëm disa:

- Agjërimi prishet nëse personi ha ose pi gjëra të cilat nuk përdoren zakonisht si ushqime dhe si pije dhe që natyra njerëzore nuk është e prirë për t'i përdorur si ushqime dhe pije, p.sh. ngrënia e dheut, orizit të pagatuar, brumit të papjekur, miellit, arrat jeshile që akoma nuk kanë thelb e të tjera të kësaj natyre. Ngrënia e tyre e prish agjërimin dhe për atë duhet bërë kaza.

- Nëse ha syfyр duke menduar se akoma nuk është koha e imsakut, ose nëse bën iftar duke menduar se ka përënduar dielli; si në rastin e parë ashtu dhe në të fundit vërtetohet e kundërta.

- Kalimi në grykë i ujit të marrë me gojë ose të tërhequr me hundë, gjatë marrjes së abdesit.

- Ngrënia ose pirja me dashje pasi të ketë ngrënë ose pirë diçka me harresë, duke pandehur se është prishur agjërimi.

- Vjellja e vetëkërkuar qoftë edhe më pak se sa mbushet goja plot.

- Gëlltitja e pështymës ose lëngut të gojës së bashkëshortes.

- Përrjetimi i ekstazës seksuale (derdhja e lëngjeve seksuale te mashkulli dhe kulmi i kënaqësisë seksuale - orgazma te femra) me anë të puthjes, përqafimit ose përkëdheljes (kuptohet pa kryer marrëdhënie seksuale).

- Mbajtja në gojë e bombones, e çamçakëzit e prish agjërimin dhe duhet bërë kaza.

- Nëse personi detyrohet në marrëdhënie seksuale me përdhunë. (Përdhunë konsiderohet përdorimi i forcës, duke e kërcënuar me prerje të ndonjë gjymtyrë të trupit, ose duke ia dëmtuar atë me anë të rrahjes). Për këtë lypset vetëm kaza.

### 2. Rastet kur agjërimi prishet dhe duhet bërë kaza e kefaret-kundërshtëpërlblim

Në këtë rast bëhet fjalë për personin, i cili agjëron gjatë Ramazanit dhe e prish agjërimin me dëshirë dhe vetëdije të plotë, duke bërë ndonjë veprim, disa nga të cilat do t'i numërojmë në vijim. Ai, në këtë rast, krahas zëvendësimit të agjëritit të asaj dite që e ka prishur, detyrohet edhe me kundërshtëpërlblimin (kefaretin) përkatës:

- Me ngrënie, me pirje, me gëlltitje të diçkaje ose me përdorim ilaçesh pa justifikim ligjor.

- Në qoftë se pi duhan ose i ha fletët e tij, apo thith tymin e tij qëllimisht.

- Kryerje të marrëdhënieve seksuale me bashkëshorten (xhima') gjatë kohës kur agjëron, qëllimisht, jo nga harresa.

Në të gjitha rastet e sipërpërmendura, kur agjërimi prishet, atë ditë ose ato ditë duhen kompensuar (kaza) dhe lypset kundërshtëpërlblim (kefaret). Për prishjen e agjëritit jashtë Ramazanit nuk ka kundërshtëpërlblim (kefaret), por vetëm kaza, madje edhe në qoftë se është agjërim për kompensim të Ramazanit.

**Shkëputur nga libri 'Ilmihal i zgjeruar'  
Botim i tre komuniteteve fetare.  
Tiranë - Prishtinë - Shkup, 2018.**



# Historia e Universit NË TRE AJETE

"Ne u kemi sjellë njerëzve në këtë Kur'an shembuj nga çdo lëmi e nevojshme, ashtu që ata të marrin përvojë (mësim)." (Kur'an, 39/27)

Ka afro 1400 vite që njeriut i është dhënë mundësia që, përveç se thjesht të lexojë Kur'anin, Librin e Fundit Hyjnor, por edhe ta studiojë, ta kuptojë e të nxjerrë mësimet jetësore. Shembujt e sjellë nga Zoti nga çdo lëmi e nevojshme e jetës janë aty, në çdo ajet e faqe të Kur'anit. Por, ndoshta edhe njerëzimit i duhet të arrijë një nivel pjekurie për t'i kuptuar e për të nxjerrë mësimet nga shembujt kur'anorë.

Zbulimet e shekujve të fundit në lëmin e shkencave të natyrës, Allahu i ka bërë shkak që Drita e Fjalës së Tij të ndriçojë mendjet dhe zemrat. Nën dritën e Kur'anit dhe me lentën e astrofizikës le të depërtojmë në kohë për të përshkruar historinë e Gjithësisë.

1. "A nuk e dinë ata, të cilët nuk besuan, se qiejt dhe toka ishin të ngjitura e Ne i ndamë ato të dyja ... A nuk besojnë?" (Kur'an, 21/30)

Në ajetin kur'anor bëhet fjalë për dy faza të gjendjes së hapësirës lëndore, që njeriu mund të perceptojë me shqisat e tij. Kjo hapësirë, që përbëhet nga toka (ku çdonjëri detyrimisht kalon jetën e vet) dhe qielli (që është objekt i vëzhgimit kureshtar të përditshëm dhe i soditjes plot ëndje), konsiderohet rëndom si Gjithësi. Nisur nga ky konceptim i thjeshtëzuar i Universit, Zoti e ka informuar njerëzimin se fillimisht qiejt dhe toka ishin të ngjitura, një trup i vetëm. Kjo paraqet fazën e Gjithësisë në gjendjen fillestare. Evoluimi vijoi më tej me ndarjen e qiejve dhe tokës nga Krijuesi Fuqiplotë e i Gjithëditur. Sigurisht që kalimi nga njëra gjendje në tjetrën nuk është bërë në një çast, por ka kaluar përmes një procesi të zgjatur në kohë.

"... qiejt dhe toka ishin të ngjitura ..." Këtu fillon edhe teoria shkencore më e pranuar (deri më tani) në historinë e Universit. Modeli i Big Bang-ut ("Shpërthimi i Madh") e nis evoluimin e Gjithësisë afro 15 miliard vjet më parë,

me shpërthimin nga një zonë jashtëzakonisht e vogël (pika zero), ku gjendja e saj karakterizohet nga një dendësi lënde dhe temperatura kolosale, ngjashëm me një lëmsh të zjarrtë e shumë-shumë të dendur. Më pas shpërthimi vazhdoi me "ndarjen", proces që çoi fillimisht në formimin e grimcave të energjive të larta e, më tej, ... deri në formimin e strukturave të sotme të Gjithësisë, yjësitë, mjegullnajat, galaktikat, etj.

Procesit të ndarjes iu nënshtrua edhe sistemi ynë diellor. "Reja diellore" filloi të shembej rreth 5 miliard vite më parë, duke formuar Diellin dhe gazin periferik. Gjatë miliona viteve, për shkak të peshës së qendrave të kondensimit dhe ftohjes së gazit periferik, u krijuan planetët, satelitët, etj. U nda qartë planeti Tokë nga qielli dhe qiejt. Pra, thënë ndryshe, qiejt e tokë në fillim ishin një masë e vetme, apo "të ngjitura" dhe pastaj "i ndamë ato të dyja" siç ka njoftuar Krijuesi kuptueshëm me gjuhën Kur'anore për njeriun e shekullit VII. Nga sa u përshkrua është evidente që shkenca moderne ka ecur dhe po ecën në gjurmët e mrekullueshme të Kur'anit. Akoma nuk besojnë?

2. "Ne, me forcën Tonë, e ngritëm qiellin dhe Ne e zgjerojmë atë." (Kur'an, 51/47)

Edhe pse ky ajet ndodhet në një kapitull (sure) tjetër të Kur'anit, është e qartë lidhja dhe vijueshmëria e tij me ajetin e mësipërm (Kur'an, 21/30). "Ne, me forcën Tonë, e ngritëm qiellin..." Zoti, Krijuesi e Formëdhënës, në këtë pjesë të parë të ajetit, na sjell në vëmendje ndarjen e planetit Tokë nga qielli, nëpërmjet fjalës "e ngritëm qiellin". Ashtu siç bën mësuesi metodist i mirë, që para se të shpjegojë të rejat e mësimi, u përkujton nxënësve njohuritë e fituara më parë. Jo vetëm kaq. Me përdorimin e termit "e ngritëm qiellin", Zoti i drejtohet qenies njerëzore në cilësitë e vëzhguesit, hulumtuesit, studiuesit dhe arsyetuesit, si pikë referimi. Tashmë njeriu i studion, analizon dhe vlerëson dukuritë nga



sistemi i referimit të lidhur me Tokën, ku ai jeton.

Vrojtuar nga ky sistem referimi, procesi i "ndarjes" së tokës nga qielli perceptohet si ngritje e kupës qiellore nga toka, ngjashëm me perceptimin e "largimit" (ngritjes) së tavanit të një ndërtese për një vrojtues që ndodhet në një ashensor të tejdukshëm që zbret poshtë.

Pas kësaj kujtese, Allahu na informon në pjesën e dytë të ajetit për zhvillimet e mëtejshme të Gjithësisë "... dhe Ne e zgjerojmë atë [qiellin]". Pra, sipas Kur'anit, jeta e Universit, pas shpërthimit, me formimin e strukturave, vazhdon më tej me zgjerimin e qiellit, ashtu si njeriu që e fillon jetën nga një pikë lëngu e ngjizur dhe më pas rritet. Ky model i prezantuar në Kur'an është një Univers në zgjerim, është jo statik.

la vlen të theksojmë se, përkundër këtij modeli kur'anor, dy kolosët e mëdhenj të fizikës dhe shkencës moderne I. Njuton dhe A. Ajnshtajn, i qëndruan besnikë modelit statik (të pandryshueshëm) të Universit. Por zbulimi i astronomit anglez Hubble, më 1929, vërtetoi dhe konfirmoi saktësinë e modelit kur'anor të një Universi jo statik në zgjerim. Për më shumë, edhe mënyra si është formuluar ligji i Hubble, sipas konceptit të vrojtuesit të ndodhur në Tokë, i cili shikon një qiell në zgjerim, i shkon pikë për pikë ashtu siç është prezantuar në ajetin 47. Saktësia edhe këtë herë peshon nga Kur'ani, edhe pse logjikisht, Njutoni dhe Ajnshtajni nuk duhej të gabonin shkencërisht para Muhamedit të paarsimuar. Ky është një fakt tjetër që vërteton superioritetin e Kur'anit, si Fjala e Zotit dhe të Muhamedit, si i dërguar i Tij.

"Ndërsa atyre që u është dhënë dituria e dinë se kjo, që të është shpallur ty (Muhamed) nga Zoti, është e vërtetë dhe se udhëzon për në rrugën e Fuqiplotit, të Lavdishmit." (Kur'an, 34/6) Njeriu gabon, qoftë ai edhe shkencëtari më i madh i kohërave. A edhe pas kësaj nuk besojnë!

3. "Nga argumentet e Tij është krijimi i qiejve dhe i tokës dhe shpërndarja e gjallesave në të dyja dhe Ai, me fuqinë e Tij, mund t'i bashkojë kurdo që të dëshirojë." (Kur'an, 42/29)

Përsëri Mësuesi i Gjithinformuar, përmes këtij ajeti kur'anor, pasi na sjell në kujtesë krijimin e qiejve, të tokës, të gjithçkaje ndërmjet tyre e, edhe të gjallesave të shpërndara në to (jo vetëm në tokë) nga Allahu, na informon se të gjithë këto përbërës të Gjithësisë do të bashkohen nga fuqia e Krijuesit, kur Ai të dëshirojë. Të njëjtën gjë paraqet një tjetër ajet gjatë përshkrimit të Kiametit, por në hapësirën më të vogël që është më e kapshme nga njeriu, atë të sistemit tonë diellor: "Dhe bashkohet Dielli e Hëna." (Kur'an, 75/9) Pra do të kemi një kthim të Universit në gjendjen fillestare "pikën zero", një kthim shumë të përshpejtuar të historisë së tij në "kohën zero".

Pasi kemi ndjekur historinë e Gjithësisë, të shkuarën dhe të tashmen, pyetja që shtrohet para kozmologjisë është përtëardhmen. Cili dotë jetë evolucioni mundshëm

i mëtejshëm i Gjithësisë? Në aspektin shkencor, evolucioni i Universit varet nga ekuilibri i mëtejshëm i dy faktorëve që kundërshtojnë njëri-tjetrin: nga njëra anë është zgjerimi i Gjithësisë, që karakterizohet nga energji kinetike të larta të galaktikave dhe nga ana tjetër ky zgjerim pengohet nga tërheqja gravitacionale ndërmjet galaktikave, e cila tenton t'i afrojë ato. Nisur nga këto dy faktorë, nga raporti ndërmjet tyre, janë ndërtuar dy skenarë të mundshëm të evolucionit të Universit.

I) Gjithësia e Hapur, që pohon se Gjithësia do të vazhdojë të zgjerohet gjithmonë pafundësisht. Domethënë se ky model nuk parashikon shkatërrim të botës – Kiamet.


II) Gjithësia e Mbyllur, që pohon se lëvizja zgjeruese pas një farë kohe do të ndalet dhe do të kthehet në lëvizje tkurrëse. Domethënë pasi të ketë arritur një zgjerim maksimal, Gjithësia e Mbyllur do të fillojë të tkurret, zvogëlon përmasat derisa të vijë në origjinën me rreze zero. Tashmë ngjarjet, fenomenet, përsëriten në kahe të kundërt, njëllon si një shirit filmi i kthyer mbrapsht. Kështu që fundi i historisë së Gjithësisë do të jetë ngjeshja kolosale në zona të vogla, procesi i kundërt me Big Bang-un, që quhet Big Crunch ("Shqyerja e Madhe"). Pra ky model pohon dhe pranon shkatërrimin e botës – Kiametin.

Nga sa përshkruam përmbledhtazi, duket qartë se modeli i Gjithësisë së Mbyllur, që përfundon me Big Crunch ("Shqyerja e Madhe"), konfirmon dhe mbështet shkencërisht shpalljen kur'anore për Kiametin: "Dhe bashkohet Dielli e Hëna." (Kur'an, 75/9) dhe më gjerë "Nga argumentet e Tij është krijimi i qiejve dhe i tokës dhe shpërndarja e gjallesave në të dyja dhe Ai, me fuqinë e Tij, mund t'i bashkojë kurdo që të dëshirojë." (Kur'an, 42/29) Madje edhe terminologjia shkencore e përdorur për shkatërrimin e Universit "Shqyerja, Grisja e Madhe" (Big Crunch) është thujse e ngjashme (për të mos thënë kopje) e terminologjisë kur'anore për të njëjtën ngjarje. "Qielli do të çahet" (Kur'an, 73/18) ose "Pëlcet (çahet) qielli" (Kur'an, 84/1) etj. Përsëri nuk besojnë! "Sa e sa argumente ka në qiej e në tokë, të cilët i shohin, por ata nuk i vështrojnë fare." (Kur'an, 12/105)

Ka një dallim ndërmjet njoftimit të Kur'anit dhe modelit të Gjithësisë së Mbyllur, për kohën e fundit të Universit. Sipas modelit të Gjithësisë së Mbyllur përllogaritet që Universi të ketë jetuar çerekun e jetës së tij. Domethënë fundi i tij parashikohet pas miliarda vitesh (afro 40 miliard vite). Ndërsa Krijuesi na qartëson në Kur'an se kjo Gjithësi, ky ndërtim madhështor, do të ketë fundin e historisë së vet kurdo që të dëshirojë Ai, Arkitekti Fisnik. "... Ai, me fuqinë e Tij, mund t'i bashkojë kurdo që të dëshirojë." (Kur'an, 42/29) "Pra, falënderimi i qoftë vetëm Allahut, Zotit të qiejve, Zotit të tokës, Zotit të gjithësisë! Vetëm Atij i takon lartmadhëria në qiej e në tokë dhe Ai është Ngadhënjyesi, i Urti." (Kur'an, 45/36-37)

Historia vazhdon...





# Celësat e Qabes

## DHE AJETI I VETËM I ZBRITUR NË TË





Qabja e ndërtuar nga Ibrahimî (a.s.) kishte dy dyer. Njëra për të hyrë dhe tjetra për të dalë nga Qabja. Që të dyja dyert ishin në nivel me tokën dhe nuk kishte pengesa të tjera. Këto dyer nuk kishin çelës. Çdo kush mund të hynte dhe dilte lirshëm sa herë të dëshironte. Edhe pse ka transmetime se derën e parë e ka vendosur mbreti i Jemenit, Ebu Kerib Esad el-Himjeri, kjo nuk është e sigurt. Në vitin 605, kur fisi Kurejsh restauroi Qaben, derën hyrëse e ngritën 2.13 metra nga toka dhe i vendosën kyç. Ndërsa derën dalëse e mbyllën me mur. Lartësia e derës është 2.22 ndërsa gjerësia 1.90 metra.

Dera e Qabes dhe dera e vogël e quajtur "dera e pendesës" që të nxjerr në çati, për herë të fundit janë bërë nga mbreti Melik Abdulaziz me flori të pastër. Në derën kryesore është përdorur 280 kg. flori. Dera është bërë prej druri dhe e veshur me kornizë floriri. Ndërsa mbi derë janë shkruar emrat e bukur të Allahut. Ndërtimi i të dyja dyerve zgjati 1 vit dhe u vendosën në vend në vitin 1363 të hixhretit. Ndërsa dera e sotme është bërë nga Halidi, djali i mbretit Melik Abdulaziz.

### Çelësi i derës së Qabes

Një ndër punët e caktuara në lidhje me haxhin ishte edhe detyra e "hixhabes". Hixhabe do të thotë të kujdesesh për Qaben, të mbash çelësin dhe ta hapësh atë në kohë të caktuara për besimtarët. Këtu përfshihet edhe kujdesi ndaj vendit të Ibrahimit (a.s.), kujdesi ndaj sendeve me vlerë të saj dhe mbajtja pastër apo ndërrimi i mbulesës së Qabes.

Detyra e hixhabes mbahej nga Kusaj bin Kilab i fisit Huza. Pjesë të kësaj përgjegjësie ai bëri edhe Rifade (kujdesi për haxhilerët) dhe Sikaje (shërbimi me ujë zemzemi për haxhilerët).

Pas Kusajit këtë detyrë e mori djali i tij Abdud-dar. Dhe më pas kjo detyrë kaloi nga babai tek i biri. Në kohën kur u çlirua Mekka çelësin e Qabes e kishte Osman bin Talha djali i Talha bin Abdullah.

### I dërguari i Allahut kërkon çelësin e Qabes

I dërguari i Allahut, ditën e çlirimit të Mekës, erdhi në Qabe mbi devenë e tij. Bashkë me të ishte edhe Usame bin Zejd. Përshëndeti gurin e zi me shkopin e tij dhe filloi të bënte tavaf. Nga njëra anë bënte tavafin nga ana tjetër me shkopin e tij rrëzoi 370 statuja idhujsh që ishin përreth Qabes, duke lexuar ajetin "Erdhi e vërteta (hak) dhe u zhduk e kota (batil). Vërtet, e kota gjithnjë ka qenë e zhdukur."

Pasi mbaroi tavafin erdhi te dera e Qabes dhe zbriti nga deveja. Ndërkohë që sahabet pastronin mbeturinat e copëtuarat të statujave dhe e lanin atë me ujë zemzemi. Në këtë mënyrë Qabeja u pastrua edhe shpirtërisht edhe fizikisht. Tashmë radhën e kishin statujat brenda saj.

I dërguari i Allahut thërriti Osman bin Talhan dhe i kërkoi të sjellë çelësin. Osmani vrapoi drejt shtëpisë por nëna e tij nuk donte t'ia jepte çelësin. Ai menjëherë vendosi dorën në shpatë dhe tha: "Nënë, ose më jep çelësin ose kjo shpatë del nga vendi i saj". Pasi kuptoi se situata ishte serioze nëna ia dha çelësin dhe ai ia dërgoi Resulullahut (a.s.).

I dërguari i Allahut (a.s.) mori çelësat dhe hapi derën e Qabes. Ndërkohë që Kurejshët u habitën nga kjo, sepse ata besonin se askush tjetër përveç atij i cili kishte detyrën e hixhabes nuk mund ta hapte derën e Qabes. Në këtë

mënyrë u thye edhe një tabu. Ashtu si thyheshin statujat rreth Qabes në çdo hap që ai hidhte po ashtu me çdo fjalë dhe vepër që bënte thyheshin tabu të shumta nga mendjet e njerëzve. Resulullahu (a.s.) kur hyri brenda mori edhe Osman bin Talhan, Usame bin Zejdin dhe Bilalin (r.a.) dhe më pas e mbylli derën.

### I dërguari i Allahut brënda Qabes

Pasi hyri brenda shkoi në çdo cep të mureve bëri tekbiere dhe falënderoi Allahun. Në muret e brendshme të Qabes ishin vizatuar figura që sipas tyre ishin Ibrahim, Ismaili dhe Is'haku (a.s.), ku në duart e Ibrahimit (a.s.) qëndronin shigjeta falli. Pasi e pa këtë, Resulullahu (a.s.) tha: "Allahu i mallkoftë! Ibrahim kurrë nuk ka hedhur fall." dhe më pas urdhëroi t'i fshinin të gjitha. Pas kësaj Ai e pastroi Qaben nga brenda, fali dy rekate namaz dhe iu lut Zotit. Ai qëndroi rreth një orë brenda saj.

Para se të hapte derën për të dalë jashtë, Xhamia e Shenjtë ishte mbushur me Kurejshët e Mekës të cilët prisnin vendimin që do merrte Resulullahu (a.s.) për ata. Pas pak Profeti i mëshirës e filloi fjalën, duke theksuar se i vetmi Zot që meriton të adhurohet është vetëm Allahu dhe më pas vazhdoi me këto fjalë: "S'ka Zot tjetër përveç Allahut. Ai është një dhe nuk ka të ngjashëm. Ai e solli premtimin në vend. Ai e ndihmoi robin e Tij dhe mposhti i vetëm të gjitha ushtritë armike. O njerëz! Çfarë vendimi mendoni se do të marr për ju?" Mekasit e trishtuar me një zë thanë: "Ne mendojmë se ti do të marrësh një vendim të hajrit për ne, sepse ti je profet fisnik. Një vëlla fisnik dhe djalë i një vëllai fisnik. Fuqia tashmë të përket ty."

Pas përgjigjes së tyre Profeti i mëshirës tha:

"Ju them ato çka vëllai im Jusuf i tha vëllezërve të tij: 'nuk ka mëri për ju sot, Allahu ju faltë! Pa dyshim Ai është falësi më i madh.' Shkoni tani, jeni të gjithë të lirë. Por kini kujdes! Nga sot është ndaluar çdo lloj fajdeje dhe kamate. Çdo hasmëri gjaku dhe pasurie tashmë është poshtë këmbëve të mia. Nga tradita e xhahilijes do të lejohet vetëm Hixhabe (kujdesi për Qaben dhe mbajtja e çelësit) dhe Sikaje (kujdesi për haxhilerët dhe qerasja me ujë zemzemi)."

### Kush do të mbajë çelësin e Qabes

I Dërguari i Zotit (a.s.) ndërkohë që po zbriste shkallët e Qabes lexonte këtë ajet: "Allahu ju urdhëron që t'u jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me të drejtë mes njerëzve. Sa e mirë është kjo që ju këshillon. Allahu dëgjon dhe sheh si veproni." Ky ajet sapo i kishte zbritur ndërkohë që ishte brenda në Qabe. Ajeti tregonte qartë se ku do të shkonte amaneti prandaj dhe Resulullahu (a.s.) edhe pse xhaxhai i tij Abasi dhe djali i xhaxhait tjetër Aliu i kërkuan që detyra e hixhabes t'i jepej atyre, ai pyeti se ku është Osman bin Talha. Pasi Osmani erdhi, ai (a.s.) e lexoi përsëri ajetin e sapo zbritur brenda Qabes dhe i tha: "O Osman! Ky çelës është e drejta jote. Sot është dita për të treguar mirësi dhe mirënjohje. Urdhëro, merre atë çka Allahu ju ka dhënë. O bijtë e Ebu Talhasë, merreni këtë amanet të mbetur nga gjyshërit tuaj dhe trashëgojeni deri në pafundësi. Tani e tutje këtë çelës nga ju mund të tentojnë ta marrin vetëm zullumqarët." Që nga ajo ditë, sot dhe deri në ditën e Kiametit çelësi i Qabes mbahet nga fisi i Ebu Talhasë (r.a.).





# NGA TREGIMI KUR'ANOR PËR MERJEMEN A.S., KAM MËSUAR SE LEHTËSIMI VJEN NGA NUK SHPRESOJMË



Nga tregimi kur'anor për Merjem bint Imran, a.s., kam kuptuar se ligjet në kozmos kanë të bëjnë me njerëzit e jo me Allahun xh.sh., dhe i Gjithëmëshirshmi i vendos ligjet në kozmos për t'i udhëhequr ato, e jo që me këto ligje të kufizohet forca e Tij, Ai është i lartë mbi ato që Atij njerëzit ia përshkruajnë. Dhe ashtu siç Allahu e krijoi Ademin a.s., pa nënë dhe baba, ndërsa Havën nga brinja e Ademit, ashtu edhe të birin e Merjemes, Isain a.s., e krijoi pa baba biologjik, që njerëzve t'u bëhet argument i qartë i fuqisë dhe madhësisë së Allahut.

Nga tregimi kur'anor për Merjemen, a.s., kam mësuar se lutja e prindërve është "shigjetë" e cila gjithmonë e qëllon shenjën, gjegjësisht është lutja të cilën e pranon Allahu xh.sh., andaj duhet të lutemi për çdo të mirë për fëmijët tanë. Derisa Merjemja ishte ende në djep, nëna e saj lutej:

"E kur ajo lindi, tha: 'Zoti im! Unë linda femër, - Allahu e di më mirë se çfarë lindi ajo, - e mashkulli nuk është si femra. Unë ia vura emrin Merjeme dhe i kam lënë atë me pasardhësit e saj nën mbrojtjen Tënde nga djalli i mallkuar.'" (Al 'Imran, 36)

Për këtë, shejtani nuk ka mundur t'i afrohet Merjemes dhe djalit të saj, Isait a.s., të cilin Allahu e bëri pejgamber të zgjedhur të Tij.

Nga tregimi kur'anor për Merjemen a.s., kam kuptuar se zemrat pastrohen dhe lëmohen në mihrabe (xhami) e jo në sexhdet për namaz, varësisht lidhjes së

tyre me tesbih dhe lutje, Allahu, xh.sh., i forcon dhe i përgatit për ta ndryshuar botën, siç nënkupton ajeti:

"O Merjeme! Bindju Zotit tënd! Bëj sexhde dhe përkulu në ruku bashkë me ata që përkulen (duke adhuruar Allahun)!" (Al 'Imran, 43)

Nga tregimi kur'anor për Merjemen a.s., kam mësuar se besimtari në çdo situatë së pari i frikësohet Allahut xh.sh., dhe devotshmëria është mbi të gjitha. Kur Merjemja e pa melekun Xhibril a.s., në formën e njeriut të përsosur, fjalët e para që i tha ishin:

"...Unë kërkoj që të më mbrojë i Gjithëmëshirshmi prej teje, nëse i frikësohesh Allahut." (Merjem, 18)

Në atë moment nuk i ra ndërmend Zekerija a.s., i cili kujdesej për të dhe i cili e edukoi, as klerikët të cilët hodhën pendët e tyre nga kallami që të shohin se kush do të përkujdesej për Merjemen. Kështu është gjendja e besimtarit të singertë, në çdo moment dhe në çdo situatë së pari i bie ndërmend Allahu e pastaj njerëzit.

Nga tregimi kur'anor për Merjemen, a.s., kam kuptuar se njeriu mbetet qenie njerëzore pa marrë parasysh çfarë shkalle imani-besimi ka arritur. E para gjë që Merjemja tha, pasi lindi Isain a.s., ishte:

"...Ah, sikur të kisha vdekur para kësaj (ngjarjeje) dhe të isha harruar krejt!" (Merjem, 23)

Gabojnë ata të cilët mendojnë se besimi (imani) i bën njerëzit engjëj të cilët nuk frikësohen, nuk brengosen, nuk durojnë, nuk pikëllohen, etj. Feja vetëm na frymëzon, na bën që ta kuptojmë më mirë jetën, na bën më të ndjeshëm dhe më përgjegjës, ndërsa Merjemja e dëshiroi vdekjen pasi lindi, ngase e dinte çfarë e priste kur të shkonte me djalin e saj para popullit të saj.

Nga tregimi kur'anor për Merjemen a.s., kam mësuar se kjo

botë është vend i lidhjeve pasojë-shkak e ligjeve dhe Allahu xh.sh., askënd nuk e ka bërë të pavarur nga këto ligje; këtë do ta bënte me Merjemen a.s., kur ishte në kulmin e dobësisë dhe pamundësisë për shkak të lindjes. Por, edhe pas kësaj, Allahu e urdhëron:

"Shkunde trungun e palmës, që të bien mbi ty hurma të freskëta!" (Merjem, 25)

Allahu e di se ajo nuk mund ta lëkundë drurin e palmës, por në këtë mënyrë na mëson që të përpiqemi sa të mundemi, sikur na mëson që të besojmë se munda ynë në vetvete nuk do ta rrisë furnizimin tonë dhe as mungesa e mundit nuk do ta zvogëlojë furnizimin, por rëndësia qëndron tek ajo se të tërhiqet vëmendja te fakti se dynjaja nuk është krijuar pa qëllim dhe nuk i është lënë vetvetes, por ekziston në ligjet që Allahu i ka përcaktuar.

Nga tregimi kur'anor për Merjemen a.s., kam mësuar se ne ndonjëherë heshtim, jo për shkak të dobësisë dhe pafuqisë, por për shkak se disa njerëzve nuk vlen t'u flitet, pa marrë parasysh çfarë u themi. Njerëzit ndonjëherë dëgjojnë vetëm atë që dëshirojnë dhe pikërisht për këtë Merjemja, kur erdhi te populli i saj, duke bartur djalin e saj, Isain a.s., të cilin e kishte lindur si e virgjër, vetëm tha:

"... Unë jam betuar në të Gjithëmëshirshmin se do të agjëroj, prandaj sot nuk do të flas me askënd." (Merjem, 26)

Nga tregimi kur'anor për Merjemen a.s., kam mësuar se me problemet duhet ballafaquar me qetësi dhe maturi, se ne nuk mund ta lëvizim dynjanë kryengul, andaj nëse kemi ndonjë problem në jetë nuk duhet ta shikojmë tërë jetën si problem. Pa marrë parasysh të gjitha ato që i ndodhën Merjemes, mbetja shtatzënë dhe lindja e fëmijës si e virgjër, për të cilën populli i saj më vonë e lëndoi dhe shpifi, Allahu xh.sh. e urdhëron që

të gjitha këto t'i hedhë pas shpine dhe të jetojë momentin e jetës dhe të kënaqet më të, andaj i shpalli:

"Ha, pi dhe qetësohu. Nëse vëren ndonjë njeri, i thuaj: 'Unë jam betuar në të Gjithëmëshirshmin se do të agjëroj, prandaj sot nuk do të flas me askënd.'" (Merjem, 26)

Nga tregimi kur'anor për Merjemen a.s., kam kuptuar se lehtësimi për njeriun vjen nga nuk e shpreson dhe se ligjet që Allahu xh.sh. ka vendosur dhe përcaktuar janë të përhershëm.

Dije për Allahun në lehtësi, Allahu do të di për ty në vështirësi dhe fatkeqësi.

Askush në tokë, duke përfshirë edhe Merjemen, nuk ka mundur të mendojë se fëmija i porsalindur do të veprojë dhe mbrojë nënën e vet para gjykit të pamëshirshëm të masës, se do t'i heshtë të gjitha gjuhët e tyre dhe do të sjellë argumente për virgjërinë dhe pastërtinë e Merjemes.

Nga tregimi kur'anor për Merjemen a.s., kam mësuar se njeriu nuk do të jetë realisht i lirë nëse nuk është rob i Allahut xh.sh. Akidja (besimi) është identiteti i njeriut, teuhidi (monoteizmi) është nacionaliteti i tij, ndërsa vërtetimi i robërimit dhe i adhurimit vetëm ndaj Allahut, e vetmja biletë për Xhenet. Populli i tubuar priti të dëgjojë cili është ky identitet dhe nacionalitet i djalit të Merjemes, Isait a.s., dhe fëmija i porsalindur qartë u tregoi duke u thënë:

"Unë jam rob i Allahut. Ai më ka dhënë Librin (Ungjillin), më ka bërë profet dhe më ka bërë të bekuar kudo që të jem. Ai më ka porositur që të falem e të jap zeqat sa të jem gjallë dhe që të jem i mirë ndaj nënës sime dhe nuk më ka bërë të ashpër dhe të padëgjueshëm. Le të jetë paqja e shpëtimi mbi mua, në ditën që kam lindur, në ditën që do të vdes dhe në ditën që do të ringjallet!" (Merjem, 30-33)

**Përktheu dhe përshtati:**  
**Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi**





**Sjellja e**  
*Profetit a.s.*  
**me njerëzit**

### Të duash krijesat për hir të Krijuesit

Pejgamberi (a.s.), me moralin e tij të lartë, që ia kishte dhuruar Allahu, i vlerësonte të gjithë njerëzit pa marrë parasysh se cilës fe i përkisnin, qoftë mysliman, hebre apo i krishterë. Ja një shembull që njerëzit duhen të krenohen me këtë Profet. Një ditë teksa po qëndronte me një shok të tij pranë rrugës, aty kalon një xhenaze hebreu dhe ai menjëherë ngrihet në këmbë në shenjë respekti. Shoku i tij i thotë: "O i Dërguari i Allahut! Ai ishte një hebre!", ndërsa Resulullahu (a.s.) pa u zemëruar fare iu përgjigj: "Pse, a nuk është njeri me shpirt edhe ai?"<sup>1</sup>, pra mbi të gjitha është njeri dhe kësaj thënieje nuk mund t'i shtojmë asgjë tjetër. Nëse ne jemi ymeti dhe ndjekësit e zotërisë së kësaj thënieje, nuk kemi se si të mendojmë ndryshe nga ai.

Nga kjo thënie dhe sjellje e mirë e Profetit (a.s.), kuptojmë se njeriun vetëm sepse është njeri duhet ta duam dhe ta respektojmë, sepse kjo tregon respektin ndaj Krijuesit. Përndryshe nuk do të ishte dashuri dhe respekt i singertë.

Parim kryesor në kulturën tonë është, të duash krijesat për hir të Krijuesit, sepse Allahu e krijoi gjithësinë me dashuri. Dashuria është shkaku dhe thelbi i ekzistencës si dhe është lidhja më e fortë për bashkimin dhe marrëdhënien e krijesave njëra me tjetrën. Çdo gjë që ekziston në këtë gjithësi është një art i Allahut Fuqiplotë. Nga ky këndvështrim, nëse ne nuk i duam njerëzit që janë një art i Allahut, atëherë kemi zemëruar Allahun, ata që i don Ai dhe ata që e duan Atë. Shembull për këtë është se nëse ne futemi në pallatin mbretëror dhe nuk i përfillim fare zbukurimet dhe dekoret e tij, atëherë do të ofendohet edhe arti edhe arkitekti i saj. E njëjta gjë është edhe me bukuritë mahnitëse të këtij universi, që është një art i Allahut të madhëruar. Nga kjo pikëpamje, jo vetëm njerëzit, kafshët dhe krijesat me shpirt, por edhe ato pa shpirt duhet t'i duam. Përbuzja dhe nënvlerësimi i tyre do të thotë nënvlerësim i Krijuesit të tyre.

Mënyra e sjelljes me njerëzit mbështetet në parimin t'i duam krijesat për hir të Krijuesit. Nëpërmjet kësaj, ne si myslimanë që jemi, nëse atyre që ballafaqohemi u flasim për shpatën, mburojën, vrasjen dhe prerjen, krijojmë ndërmjet atyre dhe nesh një greminë. Dhe nëse ka ndodhur një gjë e tillë, kjo do të thotë se jemi larguar nga caqet (kufijtë) e fesë.

Një besimtar, duke filluar nga të afërmit dhe më gjerë, duhet të përhapë dritën e dashurisë, miqësisë dhe të dialogut. Çdo mysliman, përballë krijesave të tjera, duhet ta mbushë zemrën e tij me ndjenjën e mëshirës për hir të Krijuesit.

Nëse do e përmbledhim shkurtimisht, qëllimi kryesor i besimtarit nuk është të heshtë ata që nuk besojnë si ai, por t'u fitojë atyre zemrat.

### Të ligjërosh me fjalë të ëmbla dhe me shprehje të urta

Allahu e dërgoi Musain te Faraoni dhe i tha: "Flitini atij fjalë të buta, se ndoshta kujtohet a frikësohet!"<sup>2</sup>. Nga ky ajet kuptohet se megjithëse Faraoni e kishte luftuar Musain dhe popullin e tij, ai duhej t'i fliste me një gjuhë të ëmbël dhe me fjalë të buta dhe prekëse, sepse qëllimi nuk është të hakmerrësh, por t'i thërrasësh njerëzit drejt së vërtetës dhe shpëtimit. Në këtë ajet, pikë kryesore është: "Kaulun Lejinun", pra fjala e butë. Atëherë personit që është përballë teje, kushdoqoftë ai, nëse dëshiron t'i shpjegosh diçka, është kusht që t'i flasësh butë dhe të tregohesh tolerant ndaj tij. Përsëri Allahu në Kur'an thotë: "Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë."<sup>3</sup>

Nga këto ajete kuptohet se për t'u bërë një njeri i devotshëm dhe me të gjitha cilësitë e mira, duhet që gjithmonë të sillesh mirë, të jesh zemërbutë, të jesh i ndërgjegjshëm dhe të shprehesh urtë dhe butë. Në të kundërt, pra, ai i cili botën e tij të brendshme nuk e ka të butë dhe nuk sillet ashtu siç sillej Profeti, çdo lëvizje dhe veprim i këtij personi është vetëm shtirje.

Misioni i Profetit (a.s.) ishte të kumtonte Fenë Islame dhe ai gjatë gjithë jetës së tij, pa marrë parasysh asgjë, ua kumtoi të gjithëve fenë e vërtetë. Siç shkruhet në librat që tregojnë jetën e të Dërguarit të Allahut, se ai njeriu i paqes, edhe Ebu Xhehlit, armikut më të madh të Islamit, ia kishte shpjeguar dhe kumtuar Islamin më shumë se njëqind herë, pa u mërzitur fare. "Një rradhë Pejgamberi (a.s.) doli përpara nesh dhe na e shpjegoi edhe një herë fenë Islame duke na thënë: "Thoni nuk ka Zot tjetër përveç Allahut që të shpëtoni!" Aty gjendej edhe Ebu Xhehli ku kësaj thirrjeje iu përgjigj duke e tallur dhe përqeshur: "O Muhammed! Nëse të gjitha këto i bën që kur të dalim përpara Allahut, të dëshmojmë se ti e kumtove fenë, atëherë edhe një herë mua mos më fto më, sepse unë do të dëshmoj se Resulullahu e kreu me sukses misionin e tij, duke e shpjeguar dhe sqaruar sa më mirë Fenë Islame"<sup>4</sup>.

Ebu Xhehli përherë kështu e ofendonte dhe tallej me të, mirëpo Profeti (a.s.) sa herë që e takonte i tregonte për Islamin dhe asnjëherë nuk ia kthente ofendimet dhe fyerjet. Meqenëse pejgamberi i mëshirës ishte kaq i ndjeshëm në çështjen e respektit ndaj njerëzve, si ka mundësi që në ditët e sotme ka prej atyre që, duke u bazuar në fe, vazhdojnë me forcë dhe me dhunë? Ndoshta këta nuk e kanë kuptuar të dërguarin e kësaj feje, Hz. Muhamedin (a.s.).

Poshtë këtij titulli shkurtimisht mund të themi se në Islam, bazë kryesore është falja dhe toleranca,

2. Taha, 44.

3. Fussilet, 34.

4. Ibn Kethir, *el-Bidaje ue'n-Nihaje*, Daru'l-Kutubi'l-Ilmijje, Bejrut, 1992, I. 62-63.

1. Buhari, Xhenaiz, 50; Muslim, Xhenaiz, 78-81.



sepse Resulullahu (a.s.) thotë: “Bëhu tolerant që të tolerohesh.”<sup>5</sup>

Përfundimisht mund të themi se as në Islam as te Pejgamberi (a.s.), nuk ekziston urrejtja dhe mëria.

### **Të tregohesh tolerant dhe durimtar**

Dashuria, toleranca dhe durimi janë armë që mundin çdo armik dhe çelësa që hapin çdo derë. Nuk ka dyshim se tek ata që gjenden këto cilësi, nëse sot jo, nesër patjetër që do t'i hapin të gjitha dyert e kësaj bote.

Ikrimë b. Ebi Xhehli, që ishte një ndër armiq të Islamit, në kohën e çlirimit të Mekes kishte ikur nga frika. Pastaj me ndërmjetësim të zonjës së asaj krahine Ummu Hakim, ishte sjellë përpara Resulullahut (a.s.). Përpara se të vinte te Profeti (a.s.) i kishin thënë se nëse kërkon falje ai do të të falë.

I Dërguari i Allahut përpara se të vinte Ikrimë, i paralajmëron shokët e tij duke u thënë: “Po vjen Ikrimë, mos e fyeri atë duke përdorur fjalë të pahijshme për babanë e tij.” Sa futet Ikrimë, i Dërguari i Allahut ngrihet dhe e përqafton, duke i shprehur mirëseardhjen. Ikrimë nuk e imagjinonte kurrë një gjë të tillë dhe më vonë do të shprehej: “Nuk e kam harruar kurrë këtë sjellje kaq të mirë të Pejgamberit (a.s.).”

Një shembull tjetër është Abdullah bin Ubej b. Selul. Ai jetonte në Medinë me ehli kitabin (hebrenjtë dhe të krishterët) dhe mendohej sa më shumë që t'i ngatërronte myslimanët njëri me tjetrin, por nga dyftyrësia thoshte se ishte mysliman. Profeti (a.s.) edhe me atë ishte i durueshëm edhe pse e dinte shumë mirë se ai ishte hipokrit. Abdullahu gjatë gjithë jetës së tij kishte armiqësi dhe u urrente të Dërguarin e Zotit. Kur vdiq, djali i tij i kërkoi Resulullahut që t'i jepte këmbishën e vet si qefin për babain, dhe ai ia dha. Deri në atë kohë nuk kishte ardhur shpallja për mosfaljen e namazit të xhenazes së tij dhe, për këtë shkak ia kishte falur xhenazen.<sup>6</sup> Nga ky këndvështrim nuk mund të gjesësh mesazh të ngjashëm me këtë të Pejgamberit, që i paraqiti njerëzimit. Pikërisht për këtë shkak është quajtur “usuetu hasene”, me moral të lartë dhe shembull për mbarë njerëzimin” dhe s'ka mundësi që një mysliman të mendojë ndryshe nga ai.

### **Dialogu i Resulullahut (a.s.) me përfaqësuesit që vinin në Medinë në vitin e delegacioneve**

Në vitin e nëntë të hixhrit, erdhën shumë të deleguar për të përqaftuar Fenë Islame dhe ky vit u quajt “viti i delegacioneve”. Të deleguarit që vinin në Medinë, kishin kërkesa të ndryshme nga njëri-tjetri, por ajo që i bashkonte ishte se ata kishin ardhur për të treguar se edhe ata, si anëtarët e tjerë të fisit, kishin pranuar

Islamin. Kishte prej atyre që kishin ardhur për të fituar diçka, duke pranuar Islamin, por kishte edhe prej atyre që nuk e pranonin Islamin, por pranonin të qëndronin nën mbikqyrjen e shtetit Islam, duke dhënë xhizjen.

I Dërguari i Zotit (a.s.) i dëgjonte me kujdes letrat e tyre dhe i pranonte dhuratat si simbol miqësie, duke u interesuar personalisht për ta.<sup>7</sup>

Profeti (a.s.), pa marrë parasysh qëllimet e tyre, i priste me mirësi, me buzëqeshje dhe urdhëronte që të mos i fyerin, por të silleshin ashtu si Pejgamberi (a.s.) me ta.<sup>8</sup>

Fjalimet ndërmjet të deleguarve dhe Resulullahut (a.s.) kalonin aq mirë dhe aq të sinqerta, sa që shpeshherë kur thuhet për takime diplomatike, menjëherë të vjen në mendje një autoritar ekstrem, mirëpo sjellja dhe fjalët e të Dërguarit të Allahut nuk ishin ashtu.<sup>9</sup>

Në lidhje me këtë nëse do t'i përmbledhim veçoritë dhe korrektësinë e Profetit (a.s.) mund t'i radhisim në këtë mënyrë:

1- I dërguari i Allahut (a.s.) i vlerësonte dhe i respektonte të deleguarit çfarëdo besimi që të kishin, sa që i përcillte deri jashtë qytetit. Edhe kur vinin, dërgote një person për t'i pritur. Si shembull janë të deleguarit e fisit Thakif, të cilët i kishin pritur Mugire b. Shube dhe Ebu Bekri<sup>10</sup>, Allahu qoftë i kënaqur prej tyre.

2- Resulullahu (a.s.), të deleguarve u kushtonte aq shumë rëndësi, sa që kur bisedonte me ta, vishej me rroba të bukura, duke urdhëruar edhe shokët e tij që të visheshin bukur<sup>11</sup>.

3- Profeti (a.s.), para se të shfaqte mendimin e tij, më parë dëgjonte me kujdes kërkesat dhe pikëpamjet e tyre. Kurrë nuk insistonte që të deleguarit t'i bënte myslimanë me dhunë, duke ju përmbajtur ajetit: “Nuk ka dhunë në fe”<sup>12</sup>. Shembull për këtë është ngjarja në Medinë kur në vitin 630 vinë të deleguarit e fisit Himjer për të shfaqur haptazi se kishin pranuar Islamin. Pejgamberi (a.s.) këtyre u shprehet në këtë mënyrë: “Një hebre apo i krishter, nëse pranon Islamin e bëhet besimtar mysliman, çdo të drejtë që kanë myslimanët e ka edhe ai, nëqoftëse dëshironi t'i qëndroni besnikë fesë suaj, atëherë jepni xhizjen që të jeni të mbrojtur.”<sup>13</sup>

I dërguari i Zotit (a.s.) nuk i refuzoi menjëherë të deleguarit nga fisi Thakif që kishin ardhur për të pranuar Islamin, por pasi i dëgjoi me vëmendje kushtet që kishin, vazhdoi duke ua shpjeguar dëmet e propozimeve që bënin, duke qenë se binin ndesh

7. Hamidullah, “Islam Pejgamberi”, Stamboll 1980, II. 1086.

8. El-Kettani, *et-Teratibul- Idarije*, Bejrut 1346, I. 447.

9. Ahmed Onkal, *Rasulullah'in Islama Davet Metodu*, Konja (Turqi), 1981. f. 128.

10. Taberi, *Tarihut- Taberi*, Darul- Kutubil- Ilmije Bejrut 1995, II. 180.

11. El-Kettani, *et-Teratibul- Idarije*, I, 452; Hamidullah, *Islam Pejgamberi*, II. 1087

12. Bekare, 256.

13. Ibn Hisham, *es-Siretun- Nebuniye*, II. 589

5. Ibn Hanbel, *Musned*, I, 248.

6. Buhari, *Xhenaiz*, 85; Tefsiru Teube, 12 ; Muslim, *Fadailus-Sahabe*, 25.

me Islamin dhe kërkoi prej tyre që të hiqnin dorë nga këto mendime të gabuara. Pas kësaj ata e pranuan Islamin pa asnjë lloj kushti.<sup>14</sup>

4- Resulullahu (a.s.) u kishte bërë komplimente të deleguarve, duke përdorur lidhjet e ndryshme farefisnore. Shembull tipik për këtë është ardhja e delegacionit Benu Amir b. Sa'sasë, pasardhësit e Adnanit. Profeti i kishte pyetur se kush ishin? Ata i ishin përgjigjur se ishin djemtë e fisit Amir b. Sa'sasë. Atëhere i Dërguari i Zotit (a.s.) i kishte nderuar, duke u bërë komplimente: Mirëseerdhët, unë jam prej jush, por edhe ju jeni prej meje.<sup>15</sup>

5- Profeti (a.s.) kishte urdhëruar që të bëheshin vënde për të ardhurit në Medine. Kishte raste që mysafirët i merrnin edhe shokët tij në shtëpitë e tyre por, kishte raste që edhe vetë Resulullahu (a.s.) i merrte në shtëpinë e tij. Një ndër ta ishte Adij b. Hatem. Ai ishte më i urti, më i ndershmi dhe më i njohuri në fisin e tij. Ishte kryetar i fisit. Kur kishte ardhur në Medine dhe i kishin treguar Profetit se kush ishte, Pejgamberi (a.s.) e kishte nderuar duke e çuar në shtëpinë e tij. Vetë kishte fjetur në tokë, kurse atij i kishte liru shtratin. Resulullahu (a.s.) kishte folur gjatë me të. Adiji ishte habitur aq shumë nga morali i tij i lartë dhe nga jeta e tij modeste, saqë menjëherë e kishte pranuar Islamin.<sup>16</sup>

6- Një tipar tjetër i Pejgamberit (a.s.) ishte se ai ishte i mirëkuptueshëm edhe me të parespektueshmit. Shembull tipik është rasti kur kishte ardhur një delegacion nga fisi i nënës së qumështit Halimes te Resulullahu (a.s.). Prijësi i tyre ishte Diman b. Thalebe. Ky person sapo futet brenda tha: Kush nga ju është djali i Abdullahut? Profeti (a.s.) urdhëron dhe thotë: "Unë jam." Pastaj Dimani i thotë Profetit (a.s.) se do të bëjë disa pyetje që ndoshta janë të ndyra, dhe për këtë gjë dua të mos ofendoresh. I Dërguari i Allahut (a.s.) i thotë: "Urdhëro dhe pyet se nuk ofendohem." Pastaj ai e pyeti. Për çdo pyetje Pejgamberi (a.s.) i përgjigjet. Më pas bëhet mysliman dhe kthehet në vendin e tij.<sup>17</sup>

7- Një veprim tjetër i Profetit (a.s.) është se ai, për t'i ngrohur zemrat e të deleguarve në Islam, qoftë fëmijë apo skllav, u jepte dhurata. Shembull për të është se ndër të deleguarit e fisit Temim, ndodhej edhe një fëmijë. Ai (a.s.) u dha dhurata të gjithëve pa përjashtim.<sup>18</sup>

H. Muhamedi (a.s.) u kushtonte aq shumë rëndësi dhënies së dhuratave, saqë edhe kur ishte në sëmundjen e fundit të jetës, urdhëronte për tri këshilla, ndër të cilat ishte se "Ashtu siç ju kam dhuruar dhurata të deleguarve ashtu edhe ju tregoni

respekt ndaj tyre duke u dhënë dhurata."<sup>19</sup>

8- Profeti Muhamed (a.s.) mendohej me ç'kishte mundësi për të formuar dialog me njerëzit dhe vëmë re se ai e ka mbajtur përherë hapur këtë derë. Në lidhje me këtë shohim pikën më kulminante të tolerancës për të krishterët e Nexhranit, kur deshën të kryenin adhurimet e tyre. Nexhranasit, një grup prej 60 vetësh, kishin ardhur në Medine për t'u takuar me Profetin (a.s.) dhe për të vërtetuar nëse ai ishte i dërguari i Zotit apo jo. Pasi hynë në xhaminë e Medines, vjen koha për të kryer adhurimin e tyre dhe donin ta kryenin adhurimin brenda xhamisë. Disa nga sahabët i ndaluan, ndërsa i Dërguari i Allahut (a.s.) i urdhëroi shokët e tij që t'i linin të lirë që të kryenin adhurimet e tyre të krishterët e Nexhranit.<sup>20</sup>

Nëse do të bënim një rezymë të shkurtër, do të shohim se takimet që bëri Pejgamberi (a.s.) me delegacionet, kishin rëndësi shumë të madhe për pranimin dhe kuptimin e drejtë të Islamit. Dhe për këtë gjë, një rast i volitshëm si dhe një avantazh shumë i madh, ishte se ata kishin ardhur në emër të fisit.

Nëse do të dëshirojmë të arrijmë një përfundim të mirë, nuk duhet të harrojmë kurrë se duhet të jemi të arsyetueshëm dhe që duhet të ndjekim metodën e Vulës së Profetëve, Muhamedit (a.s.), sepse me të bërtitur, me dhunë dhe me zemërim, nuk mund t'i shpjegojmë asgjë tjetrit, e jo më ta bindësh.

Nuk duhet harruar kurrë se në këtë shekull, bindja është baza kryesore në marrëdhëniet me të qytetëruarit. Dhe nuk duhet harruar se në Kur'an thuhet: "Pajtimi është më i dobishëm"<sup>21</sup>. Nga kjo kuptohet se, paqja, pajtimi, dashuria, falja, shqetërimi dhe toleranca, janë çështje thelbësore në Islam. Kështu që sa të jetë e mundur, në plan të parë, duhet të nxjerrim atë që është bazë në fe. Ndërsa xhihadi kundër mynafikëve dhe sjellja ashpër kundër qafirave, duhet të jetë në plan të dytë dhe mund të bëhen vetëm në raste vështirësie. Po ta themi ndryshe, sjellja e ashpër, lufta dhe nëse është e nevojshme vrasja, janë të lidhura me kushte dhe shkaqe të ndryshme.

Sot, për të çliruar zemrat e njerëzve, një ndër rrugët më të përshtatshme është të tregosh urtësinë dhe dashurinë e kësaj feje të përsosur. Nga kjo, nuk duhet të stepemi në emër të fesë, sepse as në Kur'an, as në Traditën Profetike dhe as në mendimin e të parëve, nuk gjendet një dispozitë që e ndalon një dialog të ngrohtë ku të shprehim ndjenjat dhe idetë tona. Le që nuk mund të mendohet ndryshe një fe, që kërkon të mirën e të gjithëve dhe që i thirret njerëzit, pa përjashtim, drejt shpëtimit.

14. Taberi, *Tarihut-Taberi*, II. 179-180

15. Ibn Sa'd, *et-Tabakatul-Kubra*, Daru Sadr, Bejrut, I. 311.

16. Ibn Sa'd, *et-Tabakatul-Kubra*, I. 322.

17. Taberi, *Tarihut-Taberi*, II. 193; Ibn Sa'd, *et-Tabakatul-Kubra*, I. 298.

18. Ibn Hisham, *es-Siretun-Nebeuije*, II. 567.

19. Buhari, *Xhizje* 6, Megazi 83; Muslim, *Uesaja* 20; Ebu Daud, *Imaret* 28.

20. Ibn Hisham, *es-Siretun-Nebeuije*, II. 574.

21. Nisa', 128.





## HAFIZ XHEMAL MULLAI

### (1881 – 1959)

Libri i Shenjtë, Kur'ani, është bërë mik i përditshëm i jetës sime. Ai më thërret e më bën të mendoj gjithçka të lumtur që kam kaluar në vitet e shkollimit në Medresenë e Tiranës. Orët e mësimit më mbresëlënëse ishin ato me mësuesin e Kur'anit, Hafiz Xhemal Mullain. Ato momente mësimore që kalova me të kanë qenë e kanë mbetur vazhdimisht pjesë e jetës sime, kuptimi i punës dhe i ndjesive të mia, që edhe sot i kujtoj me dashuri, mallëngjim e respekt.

Është bukur të kujtosh sot ato vite të bukura mësimi plot nostalgji me mësuesin e nderuar të Kur'anit, Hafiz Xhemalin. Ka kaluar një kohë e gjatë prej 65 vitesh, shkëputje nga orët mësimore, por duke u vënë sot në rolin e nxënësit, shpreh respekt të veçantë për këtë mësues, i cili, me dëshirën e Allahut, ma bëri të dashur Kur'anin në zemrën time. Falë tij, unë kuptova se vërtet mund të sjell diçka të bukur në mënyrën e të kënduarit të Kur'anit. Kënaqësinë që më fali në vitet e mukabeles si hafiz në xhaminë e Pazarit të ri (Kokonozi) për katër vite me radhë, mbresa të cilat janë të gjalla edhe sot.

I veçantë do të mbetet në memorien time kursi i specializimit në universitetin El-Ez'her, në Kajro të Egjiptit, kur isha mësues në Medresenë e Tiranës, me rihapjen e saj, pas ardhjes së demokracisë. Ishte viti

1993, në provimin e Kur'anit dallohem si më i miri në tërë grupin e specializimit. Doktor i Kur'anit, në mes të auditorit, më tha: "Cili doktor ta ka mësuar Kur'anin?" Ishte një kënaqësi dhe krenari për mua, përpara një auditori të një niveli të lartë. E gjitha kjo ishte fryt i punës së një personaliteti, i cili, me potencialin e tij në fushën e Kur'anit, më mësoi respektin dhe kulturën e të lexuarit të Kur'anit.

Hafiz Xhemali ishte një personalitet i mirinformuar, me një kulturë poliedrike dhe të pasur. Ai kishte ndjeshmëri të lartë, intuitë dhe vizion për mësimin e Kur'anit e veçanërisht për memorizimin e tij.

Ora e mësimit me Hafiz Xhemalin ishte më shumë se një orë mësimi. Ajo paraqitej si një orë shpirtërore, ku të gjithë japin e marrim nga njëri-tjetri, sepse në krye qëndronte specialisti i mësimdhënies, i cili i menaxhonte në mënyrë të harmonizuar të gjitha hallkat e mësimdhënies. Kjo ishte pozita e Kur'anit që i bënte nxënësit ta duan atë e të bëhen protagonistë të tij. Sjellja e tij i jepte autoritetin e mësuesisë në përmbushjen e misionit edukativ në shkollë dhe si qytetar jashtë saj.

Hafiz Xhemali ishte një personalitet me virtyte e cilësi shpirtërore që rrezatonte energji e gjallëri e me këtë sfidonte edhe moshën e tij. Mësimi i tij ishte i shenjtë,



sepse përçonte te nxënësit me saktësi mesazhin hyjnor. Me përkushtimin e tij në orën e mësimi ai ishte konkret, praktik dhe i drejtpërdrejtë. Nuk i ndante aftësitë e tij të mësimdhënies nga ato edukative dhe për këtë kishte fituar respektin e prestigjin dhe bashkë me këtë edhe dinjitetin e autoritetin personal. Ishte shembull pozitiv për nxënësit, i paanshëm dhe objektiv, i drejtë dhe real në raport me kërkesat ndaj nxënësve.

Për ne, ai përfaqësonte mirësinë, dashurinë, harmoninë, respektin, mirësjelljen dhe optimizmin. Nuk u dëshpërua asnjëherë dhe se humbi shpresën me nxënësit që paraqisnin dobësi, por punoi me zell e dashuri me ta. Ishte këmbëngulës dhe i aftë për të qenë gjithmonë i arsyeshëm e i matur në veprime me nxënësit.

Ai e reflektonte personalitetin e tij edhe në pamjen e jashtme. Thjeshtësia e tij shoqërohej me pastërtinë dhe elegancën. Stili i veshjes me hijeshi ishte shembull që edukonte. Reflektonte vlera të mirëfillta njerëzore, sepse u përpoq të kultivojë te nxënësit humanizmin dhe solidaritetin, që janë pjesë e domosdoshme e karakterit të një besimtar. Hafiz Xhemali zotëronte disa gjuhë të huaja, veçanërisht arabishten, që është gjuha e Kur'anit.

Kultura gjuhësore përbënte një aspekt të rëndësishëm të personalitetit të tij si mësues i Kur'anit, që vlerësohej si bazë në zhvillimin intelektual, emocional e shoqëror për nxënësit e tij. Gjuha arabe është elementi bazë i mësimi të Kur'anit. Nëpërmjet një pune sistematike na mësoi se si të shqiptojmë shkronjat e fjalët, bukur e pa gabime. Jo vetëm kaq, por ai e përqendronte vëmendjen edhe te zotërimi i normave dhe rregullave të texhvidit.

Një formim i tillë i jepte personalitetit të tij një forcë të madhe që dallohej për individualitetin, nga leximi melodioz, te zëri kumbues i mrekullueshëm, që shërbenin si model, jo vetëm për nxënësit, por për të gjithë teologët vendas. Ai zotëronte "shtatë mënyrat" e leximit të Kur'anit, i vetmi ndër teologët shqiptarë. Punë të veçantë Hafiz Xhemali bënte me grupin e nxënësve që ishin përfshirë në memorizimin përmendësh të Kur'anit. Si mësues në Medresenë e Tiranës ai përpiqej të zbulonte botën shpirtërore të nxënësve dhe provonte aftësitë dhe shprehitë e secilit, për të bërë përzgjedhjen e disa individëve për memorizimin e Kur'anit, si hafizë të ardhshëm, pjesë e të cilëve isha edhe unë. Ai i qëndronte pranë secilit dhe ishte i ndjeshëm në mënyrën se si ai dëshironte t'i ndihmonte në artikullimin dhe shqiptimin e fjalëve. Ndikimi i tij psikologjik me taktin pedagogjik bënte që nxënësit e grupit të hafizëve të përvetësonin mirë mënyrën e leximit të Kur'anit.

Hafiz Xhemali ushqente edhe nxënësit e tjerë me frymën e ambicies për t'i edukuar me dëshirën që edhe ata të mësonin sa më shumë pjesë përmendësh.

Zotëronte një kulturë të përgjithshme teologjike, por mjaft i thelluar në njohjen e Kur'anit. Pikërisht kjo e bënte atë që të ishte shumë i përgatitur nga ana pedagogjike, didaktike dhe metodike. Nga ana tjetër pasioni për punën me nxënësit, dashuria dhe respekti për ta, kompletin figurën e tij si mësues i nderuar.

Ai zotëronte shprehitë dhe mjeshtërinë e mësimdhënies së Kur'anit, që ishte edhe çelësi i suksesit të tij si hafiz dhe mësues i Kur'anit. Metodrat e

përparuara që përdorte, përmbanin shumë elementë në të cilët përfshihej jo vetëm marrja e njohurive teknike të leximit të Kur'anit, por kjo gërshetohej ngushtë edhe me zbatimin në praktikë nga çdo nxënës. Kjo e bënte mësimin shumë tërheqës e frutdhënës. Gjatë demonstrimit që ai bënte në leximin e pjesëve të Kur'anit, atë e dominonte faktori psikologjik dhe emocional që i jepnin atij siguri e përgjegjësi specifike për artikullimin e çdo shkronje e fjale. Inteligjenca dhe aftësia mendore tek ai ishin maksimale, dhe mundësonin kontrollin e funksionimit të kujtesës në ruajtjen e memorizimit të Kur'anit e të gëzonte titullin "hafiz".

Hafiz Xhemali na e kujtonte gjithmonë citimin e ajeteve 16-19 të sures El-Kijame në Kur'an, ku Zoti thotë: "Mos nxito (o Muhamed) në leximin e Kur'anit me gjuhën tënde! Ne e kemi për detyrë t'i mbledhim pjesët e tij e ta lexojmë atë. Dhe, kur ta lexojmë atë, ti përcille leximin e tij! Pastaj, e kemi Ne për detyrë ta shpjegojmë." Me këtë na tërhiqte vëmendjen që të kishim kujdes gjithmonë në leximin e drejtë të Kur'anit, sipas normave dhe rregullave që ai na mësonte. Kjo tregonte se H. Xhemali ishte një teolog i mirëfilltë dhe jo rastësisht Universiteti Teologjik i Stambollit, ku ai u diplomua, e emëroi pedagog të sajën si dhe anëtar të Gjykatës Islame, meqë ishte diplomuar edhe në jurisprudencë.

Interesat e Atdheut e sjellin në Shqipëri për të punuar në vendin e tij. Ai u kthye kur u mbledh Asambleja Legjislative Kombëtare për herë të parë, ku edhe zgjidhet nënkryetar i saj dhe merr pjesë në përpilimin e ligjeve themelore të Shtetit Shqiptar.

Personaliteti i H. Xhemalit kishte dimension më të gjerë sesa personaliteti i një mësuesi në Medresenë e Tiranës. Për kontributin e tij për kombin dhe mospranimin nga ana e tij të pushtimit nga Italia Fashiste, internohet për pesë vjet në Itali. Por edhe këtu do të tërhiqte vëmendjen e banorëve të Bergamos.

Ai nuk hoqi kurrë dorë nga Kur'ani. Lexonte e këndonte dhe ata që e dëgjonin zërin e tij kumbues e melodioz mallëngjeheshin dhe i bënte të lotonin. Ata e konsideronin H. Xhemalin "njeri të shenjtë" dhe i drejtuan papës kërkesë që të ndërhynte për lirimin e tij para kohe prej internimit.

U kthye në Shqipëri dhe përjetoi një persekutim të dytë nga regjimi komunist, duke i sekuestruar shtëpinë dhe gjithçka kishte.

Komuniteti Mysliman, duke parë gjendjen në të cilën përfundoi ky personalitet me vlera kombëtare, e mori mësues në Medrese në moshën 63 vjeçare.

Mund të flasim pambarimisht për pedagogun e nderuar, Hafiz Xhemalin, se si e drejtonte mësimin e Kur'anit, orën e tij mësimore. Nuk do të mbaronin kurrë fjalët dhe mendimet lidhur me personalitetin e tij si parlamentar, si anëtar i Gjykatës Islame, si kryetar i shoqërisë "Bashkimi" të shqiptarëve të Stambollit, si drejtues i gazetës "Paqja" dhe si ngritës i Flamurit të Shqipërisë në Stamboll, më 28 nëntor 1912.

Një personalitet i tillë mbeti në hije për shumë kohë, derisa me vendosjen e sistemit demokratik do të merrte vlerësimin e Presidentit të Republikës me titullin "Nderi i Kombit".



# Këshillat e NJËZET E TRE Filozofëve

Si më parë edhe sot, si mbretërit, presidentët apo udhëheqësit e një shteti, kërkonin dhe kërkojnë këshilla nga dijetarët dhe të urtët. Ata këshillohen dhe bisedojnë për çdo çështje të vështirë që mund t'u paraqitet. Njerëzit, në kohë të vjetra, udhëtonin shumë larg për të gjetur një dijetar, për t'u këshilluar me të. Një mbret i përmendur i Persisë, Nushirevan Adili, duke dashur të mblidhte disa këshilla për t'i ruajtur e për t'i mbajtur me vete, u bëri thirrje të gjithë dijetarëve më të njohur të mbretërisë së tij dhe prej tyre zgjodhi njëzet e tre vetë, si më të aftët, dhe çdonjërit i vuri si detyrë të shkruante një urtësi. Dijetarët, sipas porosisë së mbretit, duke e çuar në vend urdhrin e dhënë, i plotësuan njëzet e tre këshillat, që përbëjnë me të vërtetë këshilla bazë për të cilat ka nevojë çdokush që t'i dijë dhe të veprojë sipas tyre për të gjetur secili rrugën e vërtetë, rrugën e Zotit. Këshillat që mori prej tyre, Nushirevan Adili i shkroi me shkronja ari dhe i vuri në një kornizë floriri. Ky mbret për çdo ngjarje me rëndësi më parë lexonte këshillat e filozofëve, pastaj vepronte.

## Këshillat janë këto:

Njihe vetveten. Kërko dituri sado larg që të jetë. Mos ki turp për të mësuar dhe mos e kalo jetën në padituri. Dije se dituria është më e madhe dhe më e çmueshme se çdo gjë tjetër. Njeriu më i madh është ai që e çmon diturinë. Mos e thuaj atë që tjetri nuk e thotë dhe mos kërko atë që askush nuk e kërkon.

Çmoji këshillat e dijetarëve. Nderoi fjalët e të vjetërve dhe këshillohu e bisedo me të urtët. Kërko këshillë për çdo punë prej atij që është kompetent për atë punë. Bëje çdo punë në kohën e vet. Në asnjë punë mos u nxito me tepriçë. Përpara se të fillosh një punë mendoje mirë fillimin dhe mbarimin e saj. Ki kujdes prej gjërave që mund të shkaktojnë ndonjë dëm apo fatkeqësi. Mos e provo atë që është provuar.

Të jesh i sjellshëm e i dashur e jo i ashpër e kryelartë. Të jesh i devotshëm e të kesh frikë Zotin, se për këto do të përmendesh. Përgatitu për jetën tjetër.



Mos e shit jetën e amshuar me këtë të rrejshmen. Ta dish se kursimi është pasuri. Fito emrin e mirë. Mos të të dhimbsen gjërat që thyhen dhe derdhen. Mos u gëzo për të keqen e tjetrit.

Mësoni nga pësimi i tjetrit. Më mirë dëmi që vjen me kohë se fitimi që vjen pa kohë. Të jesh i dashur me gjithkënd dhe mos u bëj i ngutshëm dhe i ngushtë. Të jesh mik me mikun dhe me armikun. Mos i zgjat këmbët përtej kufirit.

Punët tuaja peshoji me masën – peshën tënde. Mos prek aty ku nuk ke vënë. Ji fisnik. Ruaji duart dhe gjuhën e mos i përlyej. Ruaju prej punëve të dobëta dhe të papëlqyeshme. Largoju mikut të keq.

Mos i përkrah, mos i ndihmo të pandershmit. Largoju fqinjët të keq. Mos bëj rrugë pa shok. Mos udhëto me shokun e keq. Mos mbill pemë-fidanë në tokë të huaj.

Mos hidh farë në tokën që nuk prodhon. Mos hy në borxh tek ai që e ka fituar pasurinë rishtas. Mos u bashko me ata që nuk dinë të çmojnë veten. Mos u bashko me shërbëtorët e huaj. Largohu dhe ki frikë nga ai që nuk e ka frikë Zotin.

Mos të të dhimbset ajo që shpenzohet me vend. Mos e ndero njeriun e dehur dhe të marrin. Ndero vetëm ata që i pranojnë dhe i çmojnë këshillat. Të jesh i mëshirshëm dhe bujar ndaj të rinjve dhe ndaj atyre që punojnë për ju. Mos i lakmo gjërat e huaja.

Mos ha bukë përpara atij që është i uritur. Jepi dhe ushqejë atë. Largohu dhe ruaju nga madhështia dhe kryelartësia e njerëzve.

Ruaje dhe kije kujdes shumë gjënë e huaj. Mos lejo dhe mos sill çdo njeri në shtëpi. Mos ndërhy midis bashkëshortëve. Mos i beso kujtdo. Përpiku të njohësh të vërtetën prej kujtdo që do ta dëgjosh.

Thuaje të vërtetën edhe sikur të jetë e hidhur. Mos i bëj askujt padrejtësi. Mbaje fjalën dhe kryejë premtimin. Mos jeto në armiqësi me njerëz. Jeto me paqe e miqësi me ta dhe sidomos me fqinjët.

Të jesh mikpritës. Të mos kesh asnjeri haset-smirë. Ndero dhe respekto prindërit. Mos shko askund i paftuar. Ndihmo dhe përkrah këdo nëse ke mundësi.

Ai që turpërohet nga mësimi nuk është njeri. Shpëtimi i njeriut sigurohet me gjuhë.

Fjala e dhënë nuk kthehet. Çdo e mirë vjen nga e vërteta.

Mos e mëso gjuhën me fjalë të dobëta e të ndyra. Mos dëgjo biseda të dobëta. Mos padit askënd. Mos i fol atij që s'të dëgjon. Atë që ke thënë, bëje!

Bashkohu me njerëz të mirë e të ndershëm dhe vizitoji ata. Mos e fut atë që nuk e di dhe mos e puno atë që nuk je i zoti. Kujtoji të vdekurit, kujto veprat e atyre dhe mos fol ndonjë fjalët të keqe për ta.

Mos gënje. Ruaju rrenës e besës që përdoret në rrenë. Dije se e vërteta e ardhshme është më e mirë se kjo. Ruaju të drejtave të jetimëve, të mos abuzosh. Ruaju pleqërisë dhe përgatitu për të derisa të jesh i ri.

Mos i lër punët e dimrit për në verë. Mos përdor barna për mjekim derisa të jesh i shëndoshë. Për t'u shëruar shko vetëm te mjekët e mirë dhe të sprovuar dhe përmbaju këshillave të tyre.

Ruaju smirës dhe smirëziut. Bujaria le të jetë zanati yt. Mos e shtrëngo atë që nuk i ka mundësitë. Tërhiqi vërejtjen mikut kur bën gabime.

Jepu fëmijëve profesione. Fshihe gjendjen tënde ekonomike prej mikut dhe armikut. Mos i dëgjo, mos i kërko dhe as mos shpall të fshehtat e huaja.

Ki kujdes për çdo fjalë që flet para gjyqit. Kur je më i pasur ki kujdes më tepër. Ji i durueshëm. Pas vështirësisë vjen gëzimi e liria.

Ruaju dhe kujdesu për miqtë. Vlerësoje me të madh se veten çdo armik. Më tepër ki frikë nga armiku që të paraqitet si mik.

Kjo botë është kopshti ku hidhen farat, fryti i të cilave do të korret në botën tjetër, prandaj ç'të mbjellësh do të korrësh. Më parë studioje mirë njeriun e pastaj bëhu mik me të.

Nderoje e kujtoje Zotin Fuqiplotë e ruaju prej mëkatit. Filloje çdo punë me emrin e Zotit dhe do të jesh fatlum në të dy jetët.

Këto ishin njëzet e tre këshillat e njëzet e tre filozofëve që ia përgatitën mbretit persian të asaj kohe, Nushirevan Adilit. Të gjitha janë të vlefshme për çdo njeri, sikurse kanë qenë edhe për atë që i kërkoj për t'i ditur dhe i ruajti me shumë kujdes, sepse secila nga këto këshilla ka një kuptim më vete.





# *Udikimi i dhunës psikologjike*

Çdo ditë dëgjojmë dhe përballemi me fragmente të dhunës, qoftë psikologjike apo fizike. Sigurisht që ekzistojnë faktorë të ndryshëm të lidhur me raste të tilla, të cilët ndikojnë tek të gjithë ne, familjet tona dhe shoqëria. Pikë së parë moskontrollimi i zemërimit është shkak për rritjen e problemeve. Zgjidhja e shumëpritur gjithmonë qëndron në mundësinë e ruajtjes së kontrollit dhe qetësisë. Dhuna fizike duket, sepse lë shenja, por dhuna psikologjike është më afatgjatë dhe më dërmuese.

### **Si duhet ta trajtojmë temën e dhunës në familje?**

Familja është pjesa më e vogël e shoqërisë dhe në të njëjtën kohë njësia e strehimit psikologjik të individit. Martesa, e filluar si një udhëtim i përbashkët në ditë të mira e të këqija, cenohet nga ndarja në momentet e para të krizës.

Nënvlerësimi i vlerave shoqërore dhe rritja e egoizmit të individit shoqërohet me një rënie në prirjen për të duruar palën përballë dhe lidhjen bashkëshortore. Dhunë konsiderohet çdo veprim i cili e dëmton njeriun fizikisht ose psikologjikisht. Të gjitha llojet të dëmtojnë, qoftë kjo dhunë fizike, psikologjike, ekonomike apo seksuale.

### **Dhuna fizike shfaq shenjat e saj haptazi, duam të dimë shenjat e dhunës psikologjike:**

Dhuna psikologjike ka një shtrirje më të gjatë kohore dhe është më e lodhshme. Ajo pasqyrohet në sjellje të tilla si p.sh.:

- nënvlerësimi i mendimit të bashkëshortit/tes
- ngritja e zërit, ofendimi,
- kritikimi i vazhdueshëm i bashkëshortit/tes ,
- tallja,
- të mbash mëri dhe të krijosh mure ndarëse,
- të krijosh vazhdimisht situata të ndera në shtëpi,
- të krahasosh bashkëshortin/ten me të tjerët dhe ta bësh të ndihet i/e pamjaftueshëm,
- të pengosh zhvillimin profesional të bashkëshortit/tes.
- të qëndrosh larg jetës seksuale pa pasur asnjë problem fizik,
- të vendosësh distancë emocionale,
- të flasësh me nënkuptime,
- të ndërhysh në çdo veprim të bashkëshortit/tes
- të përpiqesh të ndryshosh palën përballë,
- ta ndalosh të takohet me familjen e tij/saj
- të mos tregohesh i dashur me të.

Të gjitha veprimet e mësipërme hyjnë në grupin e sjelljeve që pasqyrojnë dhunën psikologjike. Sjellje të tilla zgjasin për një kohë të gjatë dhe kjo ndikon në ftohjen dhe distancimin e bashkëshortëve.

Në shumicën e rasteve njerëzit ushtrojnë dhunë psikologjike mbi të tjerët dhe nuk janë në dijeni të saj dhe kjo u duket diçka krejtësisht normale. Në këtë rast duhet kërkuar ndihmë ose mbështetje psikologjike nga specialistët.

Çdo lloj dhune është një rrugë e përdorur nga njerëzit e dobët, të cilët nuk arrijnë të zgjidhin problemet në

mënyrë të shëndetshme. Ndër shkaqet e kësaj dhune mund të radhisim disa si çrregullimet e personalitetit, alkooli, vartësia nga lëndët narkotike. Më shqetësues për shoqërinë tonë është normalizimi i dhunës, konsiderimi i saj si diçka normale dhe e thjeshtë. Në këtë mënyrë ne ligjërojmë mungesën e vetëkontrollit, bindjen ndaj personave të zemëruar dhe pranimin e reagimeve të papranueshme.

### **Si mund ta kontrollojmë zemërimin?**

Si fillim personi i zemëruar duhet të përcaktojë veprimin apo sjelljen që e nervozon dhe të ndjejë nevojën e kontrollimit të këtij zemërimi. Zemërimi është një ndjenjë natyrale, e cila i është dhënë njeriut për të mbrojtur veten. E rëndësishme është mënyra e pasqyrimit të tij. Pikë së pari analizohet sjellja që shkakton zemërimin, njerëzit përreth, ngjarja dhe më pas duhet të gjendet arsyeja e zemërimit. Çfarë mendon në situata të tilla, çfarë rreziku mendon se i kanoset dhe cilat ngjarje apo trauma nxiten. Pa gjetur përgjigjen e këtyre pikave nuk arrijmë tek arsyet e zemërimit. Të marrësh frymë thellë, të bësh ushtrime qetësuese dhe të largohesh nga vendi i ngjarjes të ndihmon të japësh reagime pozitive dhe parandalon shpërthimet e frikshme. Mbajtja nën kontroll e zemërimit është diçka që mund të arrihet për të parandaluar veprimet e dhunshme.

### **Cilat janë ndikimet e dhunës në familje të fëmijët?**

Frika ndikon negativisht në rritjen e zhvillimin e tyre, nuk arrijnë të jetojnë fëmijërinë. Krijon tek ata mendimin se janë të pafuqishëm, të pamjaftueshëm për të bërë diçka. Humbasin ndjenjën e besimit, sigurisë duke qenë dëshmitarë të grindjeve mes prindërve. Fëmijët e pasigurt në vetvete nesër do të shndërrohen në individë të pasigurt dhe të pasuksesshëm.

Dhurata më e bukur që mund t'i bëjnë prindërit fëmijëve është dashuria, respekti ndaj njëri-tjetrit dhe një familje e qetë. Rruga e vetëbesimit, suksesit dhe lumturisë kalon nga një familje e mbushur plot dashuri e respekt.

### **Si mund të parandalohet dhuna në familje?**

Parandalimi i dhunës në familje kërkon një punë, angazhim shoqëror dhe përkushtim maksimal nga të gjithë ne. Mënyra më efektive e zgjidhjes është edukimi dhe jo dënimi. Kohëve të fundit një rol të rëndësishëm luajnë edhe psikologët apo mbështetësit socialë në përcaktimin e problemit që shkakton dhunën dhe gjetjen e zgjidhjes.

Nga ana tjetër në shoqëri duhen krijuar modele të shëndetshme, të cilat mund të ndiqen nga të rinjtë e të rejat. Media dhe organet e saj mund të organizojnë programe reflektuese të vlerave edukative dhe morale. Familjet e shëndetshme lindin breza të shëndetshëm. Le të shpresojmë të kemi familje të lumtura mbushur me fëmijë plot energji pozitive dhe dashuri e respekt për njëri-tjetrin.



# PAPAJA

## DHE VEÇORITË E SAJ SHËRUESE



Papaja është një frut ekzotik dhe i shijshëm që kohët e fundit po bëhet pjesë në disa receta të mjekëve për shkak të bollëkut të elementëve ushqyes dhe përbërësve mjekësorë që përmban. Ajo është një frut i ëmbël dhe me aromë miski me një formë që i ngjan një dardhe të madhe. Kur piqet, ajo ka një strukturë të butë dhe një ngjyrë të verdhë-portokalli. Pjesa me tul e një papaje konsumohet duke hequr lëkurën e jashtme dhe duke e prerë atë në copa, të ngjashme me atë të një mangoje. Ajo bëhet më e shijshme nëse ftohet pak pas këtij procesi prerjeje. Mund të ketë shije pak më ndryshe në fillim pasi nuk është aq e ëmbël sa disa fruta të tjerë, por shpesh, me kohën, dikush mund të mësohet me shijen e saj unike.

Duke marrë parasysh sasinë totale të prodhimit të frutave tropikalë në botë, papaja renditet në vendin e tretë me 15.4%, duke u renditur pas mangos me 52.9% dhe ananasit me 26.6%. Mjaft interesant është fakti se, Kristofor Kolombi, kur e provoi për herë të parë, e quajti papajën "Fruti i Engjëjve". Bima e Papajës fillon të japë fryte brenda tre viteve pasi të jetë mbjellë dhe sot mund të rritet pothuajse në të gjitha stinët e vitit me sezonin e saj kulmor që shtrihet nga fillimi i verës deri në vjeshtë. Papajat nuk janë rezistente ndaj të ftohtit dhe rriten vetëm natyrshëm në klimat tropikale, megjithatë është e mundur që të rriten edhe në rajone jo-tropikale duke përdorur shtëpi serra.

Në vitet e fundit, ka pasur një rritje të konsiderueshme në numrin e studimeve shkencore të bëra për pemët dhe perimet tropikale në përgjithësi. Arsyeja e veçantë për këtë interes është vetë fakti se frutat tropikale janë të pajisur me substanca shumë të veçanta që forcojnë sistemin imunitar. Ndërsa moti i ngrohtë dhe reshjet e bollshme në klimat tropikale mund të sigurojnë një mjedis të përshtatshëm për riprodhimin e mikrobeve, dhe për pasojë epidemitë, frutat që rrisin sistemin imunitar janë të mirëseardhura si një mjet shumë i rëndësishëm për të shëruar dhe larguar këto sëmundje. Me sa duket, Toka është modeluar si një farmaci e veçantë për ne, që është plot mjete shëruese të të gjitha llojeve, formave dhe madhësive të ndryshme.

Si një nga këto kura të mundshme që po vazhdon të marrë interes në rritje shkencore, papaja është përdorur tashmë për një kohë të gjatë në mjekësinë tradicionale kundër astmës, ulcerave të lëkurës dhe stomakut, sëmundjeve parazitare të kribave të zorrëve, ekzemës, diabetit dhe gjendjeve të ndryshme të etheve. Përveç kësaj, hulumtimet në vitet e fundit treguan se ky frut luajti një rol pozitiv në shërimin e plagëve, trajtimin e sëmundjeve kardiovaskulare, kancerit, sëmundjet e kërpudhave, malarien dhe ethet Dengue - një epidemi virale e veçantë për klimat e nxehta që transmetohet përmes mushkonjave dhe karakterizohet nga dhimbje të forta të kyçeve dhe muskujve. U zbulua gjithashtu se papaja është e dobishme kundër niveleve të larta të lipideve dhe uljeve të papritura të sheqerit në gjak.

Frutat e papajës përmbajnë substanca me përfitime mjekësore si antioksidantë, betakaroten, vitamina A, B dhe C, kalium, magnez, acid pantotenik, acid folik dhe fibra, të cilat janë shumë domethënëse për funksionimin normal të trupit dhe janë të bekuara me veti kurative. Të gjitha këto vitamina dhe minerale janë efektive në forcimin e metabolizmit të njeriut. Papaja mund të ndihmojë në uljen e rrezikut të kancerit të zorrës së trashë falë përmbajtjes së tij të acidit folik, vitaminës C, beta-karotenit dhe vitaminës E.

Nëse merret rregullisht, përshpejton metabolizmin dhe lejon djegien e yndyrave për prodhimin e energjisë. Djegia e yndyrave ka shumë përfitime për një person, veçanërisht në lidhje me shëndetin e tij kardiovaskular. Për më tepër, fakti se ato janë të pasura me vitaminë A ndihmon në parandalimin e problemeve të mushkërive. Njerëzit që kanë prirje për kancer të mushkërive mund të konsiderojnë shtimin e këtij fruti në dietën e tyre ditore.

Papaja është një ushqim i qëndrueshëm për një kohë të gjatë pasi është një nga frutat e pakta me një përmbajtje shumë të lartë të fibrave, duke e bërë kështu atë frutin e përsosur për ata që dëshirojnë të humbin peshë. Papajat ndihmojnë trupin e njeriut për të luftuar kundër sëmundjeve falë përmbajtjes së saj në vitamina, e cila është gjithashtu e rëndësishme për ruajtjen e shëndetit të lëkurës.

Një enzimë tretëse e quajtur "papain" është zbuluar në

papaja. Papaina doli të jetë efektive në trajtimin e plagëve dhe alergjive, veçanërisht problemet e sistemit të tretjes. Një studim tregoi se, falë vetive të tyre anti-inflamatore dhe imunitare-moduluese, papajat mund të jenë të dobishme kundër shumë sëmundjeve kronike të tilla si artrozat dhe artriti reumatoid. Forcimi i sistemit imunitar është i dobishëm për të ndihmuar në parandalimin e infeksioneve të tilla si gripi, një shqetësim shumë aktual, duke marrë parasysh se shumë vende të botës ende po përballen me pandeminë Covid-19. Enzima "kimopapain", megjithëse gjendet në sasi më të vogël, gjithashtu ka efekte të ngjashme.

Një studim tjetër tregoi se këto enzima, të cilat gjithashtu ndihmojnë në tretjen e proteinave, janë të dobishme kundër deformimeve të kornesë në sy dhe me trajtimin e pickimeve të insekteve. Kërkimet kanë treguar se shtimi i papajës në dietën tonë është një ide e shkëlqyeshme për zvogëlimin e rrezikut të degjenerimit makular (njolla e verdhë), i cili ndodh në sy ndërsa plakemi dhe mund të shkaktojë po aq dëmtime sa humbja eventuale e shikimit.

Brenda papajës ka fara të shumta të zeza që i ngjajnë farës së piperit të zi. Këto fara janë shumë të dobishme për nxitjen e detoksifikimit të trupit. Dihet që këto fara janë të dobishme kundër sëmundjeve të caktuara të veshkave së bashku me infeksionet e E. coli, Salmonella dhe Stafilokoku. Për më tepër, lëngu i nxjerrë nga farat e tij është efektiv për pastrimin e mëlçisë dhe largimin e parazitëve të zorrëve. Farat mund të ruhen përmes tharjes dhe më pas të konsumohen duke i shtypur si pluhur. Kjo mund të shtohet në sallata ose të konsumohet si pjatë e dytë.

Shkaku më i rëndësishëm i goditjeve në tru është oksidimi i kolesterolit. Kolesterolit fillon të grumbullohet në muret e enëve të gjakut kur oksidohet, dhe ky akumulim mund të çojë në paralizë për shkak të pllakave që formojnë dhe pengojnë rrjedhjen e gjakut në tru. Meqenëse papajat janë të pasura me antioksidantë ato ndihmojnë në parandalimin e sëmundjeve kardiovaskulare të shkaktuara nga arteroskleroza dhe diabeti, duke parandaluar oksidimin e kolesterolit dhe uljen e nivelit të tij në gjak.

Disa studime sugjerojnë se papaja rrit rrezikun e abortit të gratë shtatzëna kur konsumohet në sasi të tepërta. Detajet se çfarë e shkakton këtë gjendje janë ende nën hulumtime. Përveç këtij rreziku specifik, duket se nuk ka asnjë pengesë të njohur për konsumimin e papajave. Sidoqoftë, është e logjikshme që dikush duhet të vendosë ekuilibër dhe moderim, edhe kur konsumon gjëra të dobishme. Është gjithashtu e dobishme të kërkon kurime nga shumë burime, në vend që të mbështeten vetëm në një.

Ndoshta studime serioze dhe të gjera në të ardhmen do të zbulojnë fakte të tjera interesante për frutat e tjera të bekuara, që janë të pajisura me veti të ndryshme kuruese.

**Përkthehu: Erjon Sukaj**



## Dorëzohani fëmijëve çelësat e suksesit

Dorëzohani fëmijëve çelësat e besimit të vetja, të sinqeritetit dhe tek të folurit drejt. Asgjë tjetër nuk e nxit gënjeshtrën dhe dinakërinë siç e nxit dhuna, dajakua dhe ashpërsia. Pasojat e dhunës janë aventurat e rrezikshme, nëse fëmijët kanë personalitet të fortë, ose dorëzimi dhe mbyllja në vetvete nëse janë të dobët personalisht.

Dorëzohani fëmijëve çelësat e suksesit, duke i udhëzuar dhe orientuar me qetësi, me biseda miqësore, marrëdhënie të ngushta, durim të madh, fjalë të mençura, të cilat do i shoqërojnë si melodi për sa të jenë gjallë. Mos mendoni se zemërimet e herëpashershme dhe mëria e zgjatur në kohë janë zgjidhje. E çfarë vlere ka nëse e bëjnë diçka siç thonë ju, ndërkohë që e urrejnë me gjithë zemër e shpirt.

Një ditë do e shohin veten të lirë si të duan. Le të jetë munda ynë më i madh i fokusuar në kultivimin e dashurisë për fenë, sinqeritetin, punën, vlerat morale, urrejtjen për ligësinë, injorancën, plogështinë, anarkinë, etj.

Të kultivosh në zemrat e tyre të vogla dashurinë për namazin nuk është më pak sesa ta kryejnë atë. T'i edukojmë me urrejtjen për gënjeshtrën dhe vjedhjen, nuk është më pak se qëndrimi larg tyre.

Lutuni për fëmijët tuaj, se lutjet e mira nga ana e prindërve kanë më shumë mundësi të pranohen dhe t'u hapen portat e qiellit.

## Një burrë

"Dhe prej skajit më të largët të qytetit erdhi një njeri (burrë) që ngutej e tha: - O populli im, dëgjoni të dërguarit. Dëgjoni ata që nuk kërkon (ata që nuk kërkojnë???) prej jush ndonjë shpërblim dhe janë udhërrëfyes. E çkam unë që të mos e adhuroj Atë që më krijoi e tek Ai kthehem. A të pranoj zota të tjerë përpos Tij, e nëse Mëshiruesi do të më godasë me ndonjë të keqe, ndërmjetësimi i tyre nuk do të më vlejë asgjë, e as që do të më shpëtojnë. Atëherë unë do jem në një humbje të dukshme. Unë i kam besuar Zotit tuaj, pra më dëgjoni."

Kjo është përgjigja e arsyes së shëndoshë ndaj thirrjes së drejtë të së vërtetës. Ajo ka sinqeritet, modesti, energji, drejtësi, perceptim dhe plotësim të ritmit të fortë të së vërtetës së ruajtur.

Ky është një burrë që kishte dëgjuar thirrjen dhe i ishte përgjigjur, pasi ishte bindur nga argumentet e së vërtetës dhe logjikës. Kur zemra përjetoi të vërtetën e besimit, nxiti ndjenjat e tij, aq sa s'mund të heshte e të fshihte besimin, pasi shihte përreth vetes humbje, refuzim dhe anormalitet. Ai vrapoi pas së vërtetës që u rrënjos në ndjenjat dhe që zgjoi ndërgjegjen e tij. Ai bëri përpjekje mes popullit të tij, që ishte refuzues e kërcënues. Ai erdhi prej skajit më të largët të qytetit me nxitim për të kryer obligimin e tij: thirrje drejt së vërtetës, të pengojë të keqen dhe armiqësinë ndaj të dërguarve.

| Ramazan | Ditët | Prill<br>Maj | *Agimi<br>(Imsaku) | Lindja<br>e Diellit | Dreka<br>(Yleja) | Zamra<br>(Iqindia) | Perëndimi<br>(Akshami) | Darka<br>(Jacia) |
|---------|-------|--------------|--------------------|---------------------|------------------|--------------------|------------------------|------------------|
| 1       | M.    | 13           | 04:21              | 06:00               | 12:48            | 16:28              | 19:25                  | 20:52            |
| 2       | M.    | 14           | 04:20              | 05:58               | 12:48            | 16:28              | 19:26                  | 20:53            |
| 3       | E.    | 15           | 04:18              | 05:57               | 12:48            | 16:29              | 19:27                  | 20:55            |
| 4       | P.    | 16           | 04:16              | 05:55               | 12:48            | 16:29              | 19:28                  | 20:56            |
| 5       | SH.   | 17           | 04:14              | 05:54               | 12:47            | 16:29              | 19:29                  | 20:58            |
| 6       | D.    | 18           | 04:12              | 05:52               | 12:47            | 16:30              | 19:30                  | 20:59            |
| 7       | H.    | 19           | 04:10              | 05:51               | 12:47            | 16:30              | 19:31                  | 21:00            |
| 8       | M.    | 20           | 04:08              | 05:49               | 12:47            | 16:30              | 19:32                  | 21:02            |
| 9       | M.    | 21           | 04:06              | 05:48               | 12:47            | 16:31              | 19:33                  | 21:03            |
| 10      | E.    | 22           | 04:04              | 05:46               | 12:46            | 16:31              | 19:34                  | 21:05            |
| 11      | P.    | 23           | 04:02              | 05:45               | 12:46            | 16:31              | 19:35                  | 21:06            |
| 12      | SH.   | 24           | 04:00              | 05:43               | 12:46            | 16:32              | 19:36                  | 21:08            |
| 13      | D.    | 25           | 03:58              | 05:42               | 12:46            | 16:32              | 19:37                  | 21:09            |
| 14      | H.    | 26           | 03:56              | 05:40               | 12:46            | 16:32              | 19:39                  | 21:11            |
| 15      | M.    | 27           | 03:55              | 05:39               | 12:45            | 16:33              | 19:40                  | 21:12            |
| 16      | M.    | 28           | 03:53              | 05:38               | 12:45            | 16:33              | 19:41                  | 21:14            |
| 17      | E.    | 29           | 03:51              | 05:36               | 12:45            | 16:33              | 19:42                  | 21:15            |
| 18      | P.    | 30           | 03:49              | 05:35               | 12:45            | 16:33              | 19:43                  | 21:17            |
| 19      | SH.   | 1            | 03:47              | 05:34               | 12:45            | 16:34              | 19:44                  | 21:18            |
| 20      | D.    | 2            | 03:45              | 05:32               | 12:45            | 16:34              | 19:45                  | 21:20            |
| 21      | H.    | 3            | 03:43              | 05:31               | 12:45            | 16:34              | 19:46                  | 21:22            |
| 22      | M.    | 4            | 03:42              | 05:30               | 12:45            | 16:35              | 19:47                  | 21:23            |
| 23      | M.    | 5            | 03:40              | 05:29               | 12:44            | 16:35              | 19:48                  | 21:25            |
| 24      | E.    | 6            | 03:38              | 05:27               | 12:44            | 16:35              | 19:49                  | 21:26            |
| 25      | P.    | 7            | 03:36              | 05:26               | 12:44            | 16:36              | 19:50                  | 21:28            |
| 26      | SH.   | 8            | 03:35              | 05:25               | 12:44            | 16:36              | 19:51                  | 21:29            |
| 27      | D.    | 9            | 03:33              | 05:24               | 12:44            | 16:36              | 19:52                  | 21:31            |
| 28      | H.    | 10           | 03:31              | 05:23               | 12:44            | 16:36              | 19:53                  | 21:32            |
| 29      | M.    | 11           | 03:30              | 05:22               | 12:44            | 16:37              | 19:54                  | 21:34            |
| 30      | M.    | 12           | 03:28              | 05:21               | 12:44            | 16:37              | 19:55                  | 21:35            |



# Jeta e Sahabëve

[www.kmsh.al/botime](http://www.kmsh.al/botime)

Ky botim në dy vëllime, vjen nga Komuniteti Mysliman jo vetëm si një përmbledhje fragmentesh nga jeta shembullore e sahabëve të të Dërguarit të Allahut (a.s.), por është edhe një histori e mirëfilltë e Islamit dhe pasqyrim i hollësishëm i jetës së Profetit tonë, pasi këtui, jeta e sahabëve, si dhe shumë nga ngjarjet që rrëfohen si të transmetuara nga burimet më të besueshme të Islamit, janë të paraqitura sipas një kategorizimi dhe prezantimi në kapituj të hartuar sipas kriterit tematik. Pra, dobia e prurjes së këtij libri në gjuhën shqipe, është se ai përmbush tri qëllime:

- 1 Një njohje më nga afër me përmasën e të qenët sahab i të Dërguarit të Allahut (a.s.), të cilën e garanton pasuria dhe larmia e historive të treguara në të.
- 2 Sjell në gjuhën shqipe një histori të Islamit në fillimet e tij, të parë si mënyrë jetese e pandarë nga jeta e përditshme.
- 3 Një dimension të posaçëm të përditshmërisë së jetës së të Dërguarit të Allahut (a.s.), të cilin një biografi e ka shumë të vështirë që ta paraqesë në tërësinë e tij, për shkak të pasurisë së informacionit.

**BOTIM I RI**

